



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
në “Financë Bankë” me profile “Bankat dhe Tregjet  
Financiare” dhe “Teknologjitë e Reja Financiare”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i  
Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Drini Salko

2. Prof. As. Dr. Elona Pojani

Shtator, 2024

**RAPORTI I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Financë Bankë” ofruar nga Institucioni**  
**i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	“Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Financë Bankë” me profile “Bankat dhe Tregjet Financiare” dhe “Teknologjitë e Reja Financiare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 370, dt.23.09.2021.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022: 8 PAE 2022-2023:9 PAE/3 PAK 2023-2024: 9 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a. 2021-2022 137 studentë v.a. 2022-2023 130 studentë


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (01) 222-13123

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)

2

		v.a. 2023-2024 95 studentë
19	Komente / të tjera:	



## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. nr.177, date 19.02.2009 dhe me akreditim të fundit institucional me vendim të Bordit të Akreditimit nr.62, date 18.12.2020. UMSH sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij tre fakultete emërtuar si vijon:

- ❖ Fakulteti i Shkencave Ekonomike (FSHE)
- ❖ Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane
- ❖ Fakulteti i Informatikës

FSHE i riorganizuar me urdhrin nr.201 dt 28.05.2013 është njësi kryesore përgjegjëse e këtij program që ka në përbërjen e tij tre departamente.

1. Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet (DFBK);
2. Departamenti i Ekonoisë dhe Zhvillimit;
3. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut

FSHE në vitin akademik aktual 2023-2024 ka 44 PAE dhe 13 PAK.

Departamenti i Finance Bankë dhe Kontabilitet (DFBK ) si njësi bazë e programit të studimit të MSH në “Financë Bankë” me profile “Banka dhe Tregje Financiare” dhe “Teknologjitë e Reja Financiare” bazuar në tabelat anekse nr 1,1, 1. 2 dhe 1.4. të RVB gjatë 3 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik duke plotësuar kriterin ligjor të operimit të një njësie baze.

Departamenti i Financës Bankës dhe Kontabilitet përfshin 2 grupe mësimore kërkimore dhe ofron aktualisht tre programe studimi: Bachelor në Kontabilitet Financë; Master Profesional në Kontabilitet Financë dhe Master i Shkencave në Financë Bankë me profile.

Programit i studimit MSH në “Financë -Bankë” me profile “Banka dhe Tregje Financiare” dhe “Teknologjitë e Reja Financiare” është program studimi i riorganizuar dhe ofruar që nga viti 2021 i bazuar në Vendimin Nr. 330. dt.17.09.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Programi MSH në FB me profile reflekton përvojën më të mirë të programeve master i shkencës në sektorin financiar e bankar në vend. Ky është akreditimi i parë që do të krijojë mundësinë për përmirësime në vijim, në përputhje të Ligjit Nr.80/2015 të Arsimit të Lartë, udhëzimet që pasuan atë, si dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Prioritetet e programit MSH në FB me dy profile janë në përputhje të plotë me ato të UMSH dhe kanë të bëjnë me aksesin me të mirë të studentëve të diplomuar në tregun e punës. Programi, është konceptuar dhe hartuar me lëndë dhe module, përmban 120 ECTS dhe zhvillohet në dy vite të plota akademike.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**


ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë” në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit , ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Dr. Drini Salko dhe Prof. As.Dr. Elona Pojani. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga kordinarja teknike e ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë Bankë”, me 2 profile i ofruar nga DFBK të FSHE pranë UMSH, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm , si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në FSHE të UMSH, u realizua në datën 7 dhe 8 Shkurt 2024, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në hartuar në bashkëpunim ASCAL me UMSH. Gjatë vizitës, në FSHE, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësen e Departamentit të Financës Bankës dhe Kontabilitet dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë Mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi bibliotekën e institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit MSH në FB me profile, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse.

Pas vizitës në UMSH, GVJ hartoi draft-raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion dhe dokumentacionin shtesë të ngarkuar në platformën e ASCAL-it. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.



## LISTA E SHKURTIMEVE


<b>ASCAL</b>	<b>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Larte</b>
<b>DFBK</b>	<b>Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet</b>
<b>FSHE</b>	<b>Fakulteti i Shkencave Ekonomike</b>
<b>GVB</b>	<b>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm</b>
<b>GVJ</b>	<b>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm</b>
<b>MSH në FB</b>	<b>Master i Shkencave në Financë Bankë</b>
<b>NJSBCZHK</b>	<b>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave</b>
<b>QSHA</b>	<b>Qendra e Shërbimeve Arsimore</b>
<b>RASH</b>	<b>Rrejtji Akademik Shqiptar</b>
<b>RVB</b>	<b>Raport i Vlerësimit të Brendshëm</b>
<b>SBC</b>	<b>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë</b>
<b>UMSH</b>	<b>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë</b>
<b>VKM</b>	<b>Vendim i Këshillit të Ministrave</b>

## **Përgjigje për komentet e institucionit mbi RVJ:**

Më datë 17.07.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/18 Prot., datë 17.07.2024, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 31.07.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 906/1 Prot., datë 31.07.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:


1. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin II.1.Kriteri 2, GVJ arsyeton se pavarësisht rregullimeve që institucioni parashikon të bëjë në program pas akreditimit të tij vlerësimi ynë i referohet periudhës deri në fillim të këtij procesi bazuar në eksperiencën tonë në këtë drejtim dhe duke evidentuar situatën aktuale. Si rrjedhojë vlerësimet tona qëndrojnë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
2. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.3, Kriteri 6: GVJ i qëndron vlerësimit të bërë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin IV.5, Kriteri 5: GVJ i qëndron vlerësimit të bërë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin V.6, Kriteri 4: GVJ i qëndron vlerësimit të bërë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardin VI.4, Kriteri 5: GVJ i qëndron vlerësimit të bërë dhe **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë Bankë” me profile “Banka dhe Tregjet Financiare” dhe “Teknologjitë e Reja Financiare”**


**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë Bankë”, (MSH në FB) me dy profile ofruar nga UMSH / Fakulteti i Shkencave Ekonomike, (FSHE) në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program në fushën e financës dhe bankës ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti.</p> <p>Programi i studimit MSH në “Financë Bankë” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në strategjinë e UMSH-së. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e UMSH. Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit</p> <p><i>Evidence nr.1.Statuti i UMSH (neni nr.4)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Financë Bankë” me dy profile është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UMSH-së dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike si njësi kryesore e tij, të shprehura në planin strategjik të zhvillimit të institucionit 2018-2023 me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e aplikimit të programeve financiare dhe informatike në përgjithësi dhe të teknologjive të reja financiare në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është hartuar edhe strategjia e zhvillimit të vetë këtij programi (2021-2025) nga njësia kryesore /bazë e UMSH-së. në këtë strategji janë përcaktuar dhe zgjeruar më mirë misioni, qëllimi dhe objektivat e programit. në funksion të tyre programi plotëson më mirë nevojat në fushën e veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve informatike bashkëkohore në fushën e financës.</p> <p><i>Evidence nr.1.Statuti i UMSH</i></p> <p><i>Evidence nr.4.Plani strategjik i zhvillimit të UMSH 2018-2023</i></p>



	<p><i>Evidenca nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit MSH në FB me profile.</i></p> <p><i>Evidencë nr.6.Propozim për hapjen e programit të studimit MSH në FB me profile</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “ FB” me profile është hartuar në përputhje me Statutin e UMSH dhe rregulloret përkatëse të këtij institucioni (Kreu II dhe III ) që kanë reflektuar edhe ndryshimet në funksion të ligjit aktual në fuqi të arsimit të lartë. Ky program, i riorganizuar dhe ofruar që në vitin akademik 2021, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, DFBK, për të zhvilluar këtë program. Strategjia e institucionit që përkon po me këtë periudhë (2018-2023) mëshiron edhe objektivat e këtij programi. Institucioni ka hartuar edhe strategjinë e zhvillimit të këtij programi për periudhën 2021-2025 si një dokument më vete</p> <p><i>Evidence nr.1.Statuti i UMSH</i></p> <p><i>Evidence nr.4.Plani strategjik i zhvillimit të UMSH 2018-2023</i></p> <p><i>Evidenca nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit MSH në FB me profile.</i></p> <p><i>Evidenca nr.9.Rregullore e programit të studimit MSH në FB me profile</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e financës dhe bankës në të dy profilet e tij me fokus jo vetëm tregjet financiare por edhe teknologjitë bashkëkohore financiare i shërben këtij zhvillimi. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në fushën financës të lidhur me teknologjitë që aplikohen në të dhe që përbejnë një drejtim të rëndësishëm dhe bashkëkohor të nevojave të tregut për specialist me njohuri në këto fusha. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e financës nëpërmjet programeve informatike bashkëkohore të kërkuara nga sektori financiar privat që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive të menaxhimit të riskut.</p> <p><i>Evidence nr.1.Statuti i UMSH</i></p> <p><i>Evidenca nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit MSH në FB me profile.</i></p> <p><i>Evidenca nr.9.Rregullore e programit të studimit MSH në FB me profile</i></p> <p><i>Evidence nr.14.Plani mësimor i programit MSH në FB me profile</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit MSH në “Financë Bankë ” me dy profilet e tij është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UMSH duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësies kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UMSH i licencuar me VKM nr.177, date 19.02.2009 dhe me akreditim të fundit institucional me vendim të Bordit të Akreditimit nr.43, date 13.07.202018 ka në përbërjen e tij tre fakultete: Fakultetin e Shkencave Ekonomike Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave humane Fakulteti i Informatikës</p> <p>FSHE i riorganizuar me urdhrin nr.201 dt 28.05.2013 është njësi kryesore përgjegjëse e këtij program që ka në përbërjen e tij tre departamente. FSHE në vitin akademik 2023-2024 ka 44 PAE dhe 13 PAK.</p> <p>DFBK si njësi bazë e programit të studimit të MSH në "Financë Bankë" bazuar në tabelat anekse nr 1.1, 1.2 dhe 1.4 të RVB gjatë 3 viteve të fundit akademike ka pasur një numër të qëndrueshëm staf akademik duke plotësuar kriterin ligjor të operimit të një njësie baze.</p> <p>Organizimi i UMSH, kapacitetet dhe burimet njerëzore të njësies kryesore dhe baze ofrojnë garancinë për ofrimin e një programi MSH në Financë Bankë me 2 profile në përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij.</p> <p><b>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse nr.1.1 dhe 1.2.</b> <b>Evidencë nr.7. Rregullore e FSHE (neni 24)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e FSHE, rregulloren e DFBK, rregulloren e këtij programi studimi dhe programin e tij vihet re se janë në përputhje fusha e përgjithshme e ekonomisë që është fokus i njësies kryesore (FSHE) dhe financë kontabilitetit që është fokus i njësies bazë (DFBK).</p> <p>Bazuar në CV-të e personelit akademik (PAE dhe PAK) që zhvillon këtë program konstatohet se profili i tyre akademik dhe fusha e kërkimit shkencor përkojnë kryesisht me fokusin e programit MSH në Financë Bankë me 2 profile.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të UMSH si dhe nga takimi me personelin akademik të programit konstatohet angazhim të tyre në projekte kërkimore shkencore në fushën e financës.</p> <p>Programet e studimit në FSHE organizohen në dy nivele edhe në fushën e financës dhe kontabilitetit duke synuar të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.</p> <p><b>Evidencë nr. 7. Rregullore e FSHE</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)

10


	<p><i>Evidencë nr.8.Rregullore e DFBK</i>  <i>Evidence nr. 14.3. CV e stafit akademik të programit</i>  <i>Evidence nr.16. Programi i studimit MSH në FB</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e DFBK, organizimit të tij shohim që kjo njësi mbulon programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e financës dhe kontabilitetit. Aktualisht DFBK është përgjegjëse për 3 programe studimi, respektivisht, Bachelor, dhe MSH dhe MP në fushën e financë kontabilitetit. Edhe programi i studimit MSH në FB është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të kësaj njësie bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Evidencë Aneks tabelat përmbledhëse të RVB</i>  <i>Evidencë nr.8.Rregullore e DFBK</i>  <i>Evidence nr. 14.3. CV e stafit akademik të programit</i>  <i>Evidence nr.16. Programi i studimit MSH në FB</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>NA</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjeshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në përputhje me informacionet e marra gjatë vizitës në institucion dhe në faqen e internetit të institucionit, GVJ konstaton që institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjeshme në formën e kurseve profesionale. Kurset profesionale mund të jenë në shërbim të diplomuarve në programin MSH në “Financë Bankë” me profile për avancimin e tyre të mëtjeshëm në karrierë.</p> <p><a href="https://www.umsh.edu.al/c/232/ndermjetes-i-pasurive-te-paluaajtshme">https://www.umsh.edu.al/c/232/ndermjetes-i-pasurive-te-paluaajtshme</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit MSH në FB me dy profilet është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore (FSHE) dhe bazë (DFBK) në UMSH.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi I.3**

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UMSH dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë mes njësisë kryesore FSHE, njësisë baze DFBK dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sërë aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statutin e institucionit përfshirë dhe amendamentet në këtë dokument të miratuara në 15.12.2022 (Kreu II), rregullore e organizimit të UMSH, rregullore e programit të studimit MSH në FB me profile dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi. Një pamje të përmbledhur të strukturave përkatëse e jep edhe organigrama e UMSH e përditësuar në 15.12.2022. Po ashtu janë një sërë aktesh të tjera që disiplinojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit në të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësisë e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr.1.Statuti i UMSH</i>  <i>Evidencë nr.2. Rregullore e organizimit të UMSH</i>  <i>Evidencë nr.3.Organigrama e UMSH</i>  <i>Evidencë nr.7. Rregullore e FSHE</i>  <i>Evidencë nr.8. Rregullore e njësisë baze (DFBK)</i>  <i>Evidencë nr.8. rregullore e programit të studimit MSH në FB</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të objektivave mësimore dhe formuese të studenteve UMSH ka nënshkruar një numër marrëveshesh bashkëpunimi me 38 institucione arsimore kërkimore brenda dhe jashtë vendit, 11 marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private si dhe institucione arsimore shkencore brenda vendit dhe 24 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera private dhe shtetërore që përfshijnë edhe bankat tregtare.</p> <p>Një pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit janë realizuar kryesisht nëpërmjet projekteve të përbashkëta si Tempus, ERASMUS + etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj.</p> <p><i>Evidencë nr. 10. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UMSH</i>  <i>Tabela përmbledhëse e RVB. Lista e marrëveshjeve bashkëpunues në rang programesh studimi për praktikat profesionale. (tabela nr.5)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UMSH ka marrëveshesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FSHE, evidentuam angazhimin e institucionit për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve apo aktoreve të tjerë të biznesit për realizimin e këtij komponenti të rëndësishëm të programit. Edhe në web-in e UMSH janë të evidentuara marrëveshjet e bashkëpunimit me këto institucione</p>



<p>stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në tabelat përmbledhëse të RVB evidentohen 29 institucione bashkëpunuese në rang programesh studimor. Në këto organizata apo institucione dominojnë bankat tregtare, shoqëritë audituese të cilat janë me pranë fokusit të këtij programi.</p> <p><b>Evidencë nr. 10. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UMSH Tabela përmbledhëse e RVB. Lista e marrëveshjeve bashkëpunues në rang programesh studimi për praktikat profesionale. (tabela nr.5)</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>DFBK si njësia bazë dhe përgjegjëse e këtij programi evidenton nëpërmjet raporteve periodike të analizës vjetore analizon dhe përfshin edhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet. Analiza në nivel institucional është me e plotë. Në këtë kuadër mendojmë që kjo analize të realizohet e plote në nivel të njësie kryesore dhe baze me fokus përfitimet e programeve të studimit (përfshirë dhe këtë program) nga marrëveshjeve me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, realizimin e intershipeve të studenteve pranë institucioneve dhe bizneseve vendase.</p> <p><b>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. institucioni është aktiv duke realizuar një numër të konsiderueshëm marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit në funksion të procesit mësimor.</li> <li>2. Edhe programi i studimit MSH në "Finance Bankë" është përfitues nga këto marrëveshje bashkëpunimi.</li> <li>3. GVJ sugjeron se në kuadër të përfitimeve nga këto marrëveshje bashkëpunimi njësia kryesore dhe ajo bazë të realizojnë analiza me të plota me fokus këtë objekt, duke mundësuar dhe evidentuar me mire përfitimet e studenteve të këtij programi.</li> </ol>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>																													
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>																													
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																												
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit MSH në “Financë Bankë” në të dy profilet e tij është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë në auditor dhe jashtë auditorit me një total 120 kredite në dy vitet akademike, 4 semestra dhe me ngarkesë studentit 25 orë në javë. Në program lëndët e detyrueshme janë vlerësuar me 8 kredite dhe lëndët me zgjedhje 6 kredite. Programi është ndërtuar në rrjedhën logjike të tij. Në vitin e parë të programit të studimit merren njohuritë mbi financën dhe bankën, ndërsa në vitin e dytë bëhet dhe profilizimi përkatës përkatësisht në “Bankat dhe Tregjet financiare” dhe “Teknologjitë e reja financiare.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi MSC në FK</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>5%-10%</td> <td>12</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50%- 60%</td> <td>60</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td> <td>12%-20%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td> <td>10%</td> <td>12</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>10%- 15%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidencë nr.9. Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</i>  <i>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit MSH në Financë Bankë</i>  <i>Aneksat e RVB.tab.10</i></p>			Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi MSC në FK		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi MSC në FK																											
		Kredite	Përqindje																										
A. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%																										
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%																										
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%																										
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%																										
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%																										

**Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Nga shqyrtimi i programit mësimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet se ai përfshin 12 lende (pa përfshirë praktiken ) dhe 4 module. Në të arrihet të transmetohen njohuri me të gjera në fushën e financës dhe bankës, aplikimit praktik të njohurive në këtë fushë si dhe trajtime teoriko-shkencore në lende të veçanta duke përbushur dhe objektivat e një programi Master Shkencor. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të financës apo bankës pranë institucioneve financiare apo sipërmarrjeve private si dhe në sektorin publik.

Ky program është në vitin e tretë të zhvillimit të tij dhe në të nuk është gjykuar të bëhen ndryshime.

*Bazuar në vlerësimin tonë mendojmë që në kuadër të plotësimit më mirë të objektivave të tij , në këtë program ka nevojë të bëhen përmirësime të mundshme të cilat do t'i shërbenin me mirë një programi të ciklit të dytë të studimit në finance dhe bankë në të dy profilet e tij të tilla si:*

*Së pari; në programin e studimit në vitin e parë duhet të merren më shumë njohuri të thelluara të fushës së financës. Për këtë është e nevojshme përfshirja e njohurive të thelluara të menaxhimit të riskut nëpërmjet modulit përkatës të "Menaxhimit të riskut financiar" . Po në këtë kuadër si një program MSH në Financë Bankë përfshirja e modulit "Drejtimit Portofoli" apo " Vendimmarrja financiare "do përmirësonte më tej këtë program. Përfshirja e moduleve të mësipërme në përmirësim të programit mund të realizohej nëpërmjet dy mundësive:*

- ❖ *Heqja e lëndës "Menaxhim strategjik i institucioneve financiare" që bazuar në syllabusin përkatës nuk i referohet institucioneve financiare por menaxhimit strategjik në përgjithësi*
- ❖ *Përfshirja e më shumë lëndeve me zgjedhje në vitin e parë zgjedhje duke krijuar me shume fleksibilitet. Kjo do të rrisë me tej fleksibilitetin dhe mundësinë e marrjes së njohurive me të thelluara në finance apo banke. Lënda "Financat e korporatës" që është me zgjedhje ka mjaft mbivendosje me lenden " Drejtimit i avancuar financiar" dhe spostimi i saj do të rriste me tej mundësinë e shtimit të lëndeve me zgjedhje.*

*Së dyti; në programin e studimit në vitin e dytë të mund të theksohej me shume tipari i profileve përkatëse nëpërmjet shtimit të lëndeve të reja apo të lëndeve me zgjedhje. Një mundësi e realizimit të këtij objektiivi do të ishte edhe heqja e lëndës me zgjedhje "Drejtimi Financiar i Organizatave Publike" që është disi larg profileve përkatëse.*

- ❖ *Në profilin "Banka dhe Tregjet Financiare" të mund të shtohej lënda "Kontabilitet bankar", ose një lëndë e tregjeve financiare që mungon.*

	<p>❖ <i>Ne profilin "Teknologjitë e reja financiare" si një profil bashkëkohor të shtohen lende me zgjedhje në kuadër të vete profilit duke ofruar dije në produktet e reja financiare digjitale.</i></p> <p><b>Evidenca nr.9. Rregullore e programit MSH në Financë Banke</b>  <b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit MSH në FB me profile</b>  <b>Aneksat e RVB.tab.10</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimeve Master i Shkencave në "Financë Bankë " me profile , në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", ka përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Parashikohen 12 kredite për praktikën profesionale ose 300 orë gjithsej, nga të cilat 24 orë në auditor dhe 276 orë punë e pavarur nga studentët. Për detyrimet përmbyllëse parashikohen 18 kredite ose 450 orë gjithsej, nga të cilat 30 orë në auditor dhe 420 orë punë e pavarur nga studentët. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit i cili vlerësohet me notë, njëlloj si detyrimet e tjera.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit MSH në FB me profile</b>  <b>Aneksat e RVB.tab.10</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>NA</p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>FSHE dhe DFBK aktualisht ofrojnë vetëm këtë program studimi MSH me këtë emërtim në Financë dhe Bankë me dy profile.</p> <p>Nga analiza e tregut e kryer, konstatohet që programe të ngjashme me të njëjtën emërtesë ofrohen në IAL të tjera të vendit. Është konstatuar në analizën e tregut të punës konkurrenca veçanërisht me universitetet publike në profilet ekonomike, të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi në nivelin bachelor dhe master.</p> <p><i>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit Aneksit e RVB.tab.10</i> <i>Evidenca 14. Analiza e tregut të punës</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në RVB, UMSH ka aplikuar në Ministrinë e Arsimit përsa i përket kodit përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve për programin e studimit Master i Shkencave në “Finance Banke” si një program i riorganizuar dhe është në pritje të vendimit nga ky institucion.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. programi i studimit MSH në “Financë Banke” organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje.</i></li> <li><i>2. Megjithatë në funksion të përmirësimit të tij sugjerimet e mësipërme të GVJ lidhur me këtë program studimi do e përmirësonin me tej atë në drejtim të konsolidimit shkencor dhe aplikativ dhe konsolidimit të profileve përkatëse .</i></li> </ol>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2													
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe në tabelat e përditësuara të personelit akademik të dërguara pas vizitës në institucion FSHE si njësi kryesore përgjegjëse e programit MSH në “Financë Bankë” përmbush detyrimet ligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafet akademike për zhvillimin e këtij program. Në vitin akademik 2023-2024 FSHE përfshin në strukturën 57 anëtarë si personel akademik nga të cilët 44 anëtarë janë PAE dhe 13 anëtarë janë PAK, që janë pjese e tre Departamenteve :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Finance Bankë dhe Kontabilitet;</li> <li>2. Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit;</li> <li>3. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut</li> </ol> <p>DFBK si njësi baze përgjegjëse e programit përfshin 2 grupe mësimore kërkimore dhe plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me strukturën akademike dhe stafin akademik duke pasur një numër të qëndrueshëm stafi gjatë 3 viteve të fundit siç tregohet në tabelën e mëposhtëm :</p> <p><b>FSHE përbëhet si me poshtë:</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> <th>2023-2024</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>(20 PA) 15 PAE 5 PAK</td> <td>(30PA) 21 PAE 9 PAK</td> <td>(30 PA) 21 PAE 9 PAK</td> </tr> </tbody> </table> <p>DFBK Në vitin akademik 2023-2024 nga 30 anëtarë stafi akademik të kësaj njësie, 21 janë PAE ( nga të cilët 3 të kategorisë Profesor, 4 anëtarë me gradën shkencore Doktor , 12 anëtarë doktor në proces dhe 2 me master shkencor). Nga 9 anëtarë që janë PAK, 3 prej tyre janë të kategorisë Profesor, 1 anëtar me gradën shkencore doktor, 2 anëtarë doktor në proces dhe 3 anëtarë me Master Shkencor .</p> <p><b>Departamenti Financë-Bankë dhe Kontabilitet përbëhet si më poshtë:</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Tituj/ grada</th> <th>2022-2023</th> <th>2023-2024</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	2021-2022	2022-2023	2023-2024	(20 PA) 15 PAE 5 PAK	(30PA) 21 PAE 9 PAK	(30 PA) 21 PAE 9 PAK	Tituj/ grada	2022-2023	2023-2024			
2021-2022	2022-2023	2023-2024											
(20 PA) 15 PAE 5 PAK	(30PA) 21 PAE 9 PAK	(30 PA) 21 PAE 9 PAK											
Tituj/ grada	2022-2023	2023-2024											

	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	2	1	2
Prof. Asoc.	3	1	2	1
Dr./PhD.	3	1	5	2
Dr.proc	12	-	5	-
Msc	2	5	-	-
<b>Totali</b>	<b>21</b>	<b>9</b>	<b>13</b>	<b>5</b>

UMSH i licencuar me VKM nr.177,date 19.02.2009 dhe ka marre akreditimin e fundit institucional me vendim të Bordit të Akreditimit nr.62,date 18.12.2020 .  
 FSHE është riorganizuar me urdhrin nr.201 dt 28.05.2013 është njësi kryesore përgjegjëse e këtij program që ka në përbërjen e tij tre departamentet e mësipërme.  
**Evidencë : Tabelat përmbledhëse të RVB, nr.1.**

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga DFBK përgjegjëse për programin e studimit.Departmenti cakton një pedagog i cili procesin e realizimit të praktikës profesionale.  
 Gjithashtu FSHE ka personel ndihmës akademik në realizimin e punëve laboratorike apo në ndihme të procesit mësimor që në strukturën e paraqitur përfshihen jashtë strukturës së FSHE por në strukturën qendrore të institucionit.

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

GVJ bazuar në vizitën realizuar në UMSH dhe dosjen e aplikimit , konfirmon se në rregulloren e programit MSH në FB me profile është përcaktuar koordinatori i programeve Master në FSHE si personi që mbulon edhe këtë program dhe që është përfaqësues i fakultetit në zyrën e programeve të ciklit të dyte në nivel institucional.(Kreu II, neni 6 dhe 7 i rregullores së programit)  
**Evidencë nr.9. Rregullore e programit MSH në FB me profile Vizita në institucion**

**Konkluzione**

GVJ, shpreh se:  
 1. njësi kryesore FSHE dhe ajo baze DFBK përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

	2. rregulloren e programit MSH në FB me profile është përcaktuar koordinatori i programeve Master në FSHE si personi që mbulon edhe këtë program dhe që është përfaqësues i fakultetit në zyrën e programeve të ciklit të dytë në nivel institucional GVJ shprehet se ky kriter përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e aplikimit si dhe në vizitën e realizuar në institucion GVJ evidenton se FSHE si njësi kryesore dhe DFBK si njësi baze e programit kane informacionin e plote mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij program. Stafit akademik në këto njësi njih rregulloren e këtij program, planin mësimor dhe përmbajtjen e programit të lendeve përkatëse që zhvillohen. Informacion rreth programit gjendet dhe në faqen e internetit të institucionit. <i>Evidencë nr.2.Rregullore e organizimit në UMSH</i> <i>Evidencë nr.9. Rregullore e programit MSH në Financë Banke</i> <i>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ evidentoi dhe shqyrtoji evidenca të planeve mësimore, rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Financë Banke” me dy profilet e saj, syllabuset e lëndëve ku përfshihet informacioni i plote për ndarjen e lëndëve në semestrale, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor si leksionet ashtu edhe seminarët, orët jashtë auditorit si puna e pavarur, si dhe të gjithë komponentët formues të programit, duke respektuar VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit “. <i>Evidencë nr.2.Rregullore e organizimit në UMSH</i> <i>Evidencë nr.9. Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</i> <i>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të	Programi i studimit ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentet që në procesin e aplikimit dhe regjistrimit nëpërmjet planit mësimor dhe kuadrit rregullator të brendshëm (rregulloret e studimit në rang institucional, njësi


<p>pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>kryesore/baze, dhe nivel programi) kane informacionin e duhur. Që në procesin e pranimit , regjistrimit dhe zhvillimit të programit ashtu edhe procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve ekziston kuadri i plote rregullativ dhe informacioni i duhur për këtë qellim.</p> <p><b>Evidencë nr.1. Statuti UMSH</b>  <b>Evidencë nr.2.Rregullore e organizimit në UMSH</b>  <b>Evidencë nr.9. Rregullore e programit MSH në Financë Bank Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik dhe studentet</b>  <b>Webi i institucionit (www.umsh.edu.al)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Duke shqyrtuar programet e lendeve (syllabuset) vërejmë se ato janë ndërtuar si strukturë dhe në përmbajtje kryesisht në zbatim të VKM nr.41.date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit” e ndryshuar, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emërtimi i lëndës/modulit</li> <li>• Viti/semestri kur zhvillohet lënda</li> <li>• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën</li> <li>• Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit</li> <li>• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës</li> <li>• Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë</li> <li>• Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik</li> <li>• Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS</li> <li>• Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre</li> <li>• Format e vlerësimit të studentëve</li> <li>• Detyrimet e studentit për lëndën</li> <li>• Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse</li> </ul> <p>Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final.</p> <p>Nga shqyrtimi i detajuar i përmbajtjes lëndore (syllabusve) vërejmë se vlerësimit të i vazhduar gjate vitit i është dhënë një rendësi e madhe. Ketë e shikojmë që në pothuajse të gjithë syllabuset vlerësimi i vazhduar shkon deri në 60 % të pikëve totale të vlerësimit.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Banke</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Banke</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përparësi dhe përditësim të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe vizitën e GVJ në ambientet e UMSH shohim që nuk janë bërë</p>



vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	ndryshime në këtë program i cili tashme është në vitin e trete të zhvillimit të tij. <b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b> <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b> <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se: 1. Programi i studimit MSH në Finance Kontabilitet është i strukturuar dhe organizuar kryesisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe me objektivat formuese të këtij programi. 2. Programi i studimit ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve Përsa i përket këtij standardit II.3, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e financës dhe bankës . Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit ku është bere një gërshetim mes njohurive teoriko shkencore me ato aplikative dhe të kombinuara me realizimin e praktikës profesionale. Kjo jep mundësi punësimi në tregun e punës kryesisht të sektorit financiar e bankar. Në program dominojnë lendet e fokusuar në objektin e tij që është financa dhe kontabiliteti.  <b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b> <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b> <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabusët e lendeve) të programit MSH në Financë Bankë</b> <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e	Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e financiare dhe kontabilitetit edhe mundësinë për të realizuar kërkime shkencorë në sektorë të veçantë të cilat ballafaqohen me natyra të ndryshme të finance, kontabilitetit dhe riskut.

<p>objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga ana tjetër, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të riskut.</p> <p>Mbështetur në 12 lëndët dhe 4 modulet që ofron programi, por edhe në praktikën/intershipin të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Banke</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b></p>										
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialiste në fushën e financës. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është financa dhe banka. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimitin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Në kuadër edhe të projektit të përbashkët në hartimin e këtij programi është bashkëpunuar edhe me universitetet analoge të disa prej vendeve të BE. Zhvillimi i këtij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu me operatorët kryesor të tij nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve të fokusuar në objektin e programit.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b></p>										
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="608 1720 1426 1850"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi MSC në FK</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi MSC në FK		Kredite	Përqindje				
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi MSC në FK							
		Kredite	Përqindje								


mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	F. LËNDË BAZË	5%-10%	12	10%
	G. LËNDË KARAKTERIZUESE	50%- 60%	60	50%
	H. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12%-20%	18	15%
	I. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10%	12	10%
	J. DETYRIME PËRMBYLLËSE	10%- 15%	18	15%
	<p>Vlerësojmë se përmbushen kriteret e kategorizimit të lëndëve të programit.</p> <p>Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar në aplikimin e institucionit si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program vërejmë se ka një raport të drejtë mes formimit teorik dhe atij praktik të studenteve. Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve shikojmë se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime kryesisht në fushën e financës dhe teknologjisë financiare. Trajtimi i rasteve studimore, punëve laboratorike dhe realizimit të praktikës mësimore harmonizon realizimin e objektivave të këtij programi.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b>  <b>Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</b></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Ky program është në vitin e tretë të zhvillimit dhe GVJ nuk evidentoi përditësim në programet e lendeve. Mbeten rekomandimet e GVJ të dhëna me sipër me qëllim përmirësimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit në tregun financiar dhe kontabël.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Programi MSH në “ Financë Bankë ” i pajis studentët që zotërojnë tashmë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë</p>			




	<p>studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga risqet të natyrave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomisë.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b>  <b>Tabelat anekse të RVB, Tabela nr.9.</b></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit financiar e bankar por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektorë reale të ekonomisë apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektorëve të tjerë.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Anekset e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Programet lëndore (Syllabuset e lendeve) të programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b>  <b>Evidencë nr.5.Strategjia e programit të studimit MSH në Financë Bankë</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Struktura dhe organizimi i programit janë në përputhje me objektivat formuese dhe kualifikimin sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimit dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></li> <li>2. <i>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta</i></li> </ol> <p><i>Përsa i përket këtij standardi II.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>FSHE si njësi kryesore dhe DFBK si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi bazuar në marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës analizojnë periodikisht mundësitë e përmirësimit të programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt. Lidhur me këtë program ashtu siç edhe e kemi përmendur edhe me lart për vetë periudhën e shkurtër të zhvillimit të tij nuk ka pasur ndryshime si reflektim të tregut të punës.</p> <p>Hapja dhe zhvillimi i deritanishëm i këtij programi është bazuar edhe në dy dokumente të rëndësishëm;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Ne strategjinë e zhvillimit të këtij programi në periudhën 2021-2025 të realizuar nga FSHE (realizuar në Shator 2021 )</li> <li>❖ Analizën e tregut të punës realizuar në nivel institucional ku ky treg i lidhur me programin analizohet në faqen 2 deri 12 të dokumentit përkatës</li> </ul> <p>Nga takimi me studentet e programit pothuajse 85 % tyre janë punësuar në sektorin ekonomik dhe financiar.</p> <p><i>Evidence nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit 2021-2025</i>  <i>Evidence nr.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit në UMSH</i>  <i>Evidencë nr.15. Analiza e tregut të punës</i>  <i>Takim me studente të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën pranë FSHE dhe DFBK si dhe nga takimi me studentët e programit, Këshillit studentor dhe pjesëtarë të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, si edhe nga rregullorja e kësaj zyre rezultoi se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar. Për vetë periudhën relativisht të shkurtër të zhvillimit të këtij programi GVJ nuk eidentoi angazhim të studenteve të diplomuar në procesin e përmirësimit të programit.</p> <p><i>Evidencë nr.15. Analiza e tregut të punës</i>  <i>Takim me studente të programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>DFBK mban kontakte periodike me studentet e programit, Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës në funksion të përmirësimit të programit dhe qasjes se tij me tregun e punës. GVJ nuk e identoi këtë proces për arsyet e shprehura me lart.</p> <p><i>Evidencë nr.15. Analiza e tregut të punës</i>  <i>Takim me studente të programit dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ eidenton përkushtim të FSHE dhe DFBK në përfshirjen e studenteve dhe aktoreve të tjerë në përmirësimin e programeve të studimit por për vetë periudhën relativisht të shkurtër të zhvillimit të këtij programi nuk</i></p>

	<i>evidentoj këtë angazhim për këtë program. Përsa i përket këtij standardi II.5, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.6

#### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit MSH në "Financë Banke" me 2 profilet është i ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin, objektivat e institucionit si dhe në planin strategjik të zhvillimit të UMSH .</p> <p>Ky program studimi sipas rregullores së programit dhe akteve të tjera rregullative të institucionit ka si mision t'i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës, bankës dhe teknologjisë financiare.</p> <p><i>Shtojca nr.4. Plani Strategjik i zhvillimit të UMSH 2018-2023</i></p> <p><i>Evidence nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit 2021-2025</i></p> <p><i>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>FSHE dhe DFBK bazuar në statutin e UMSH bashkërendojnë procesin mësimor e shkencor të programeve të studimit përfshirë edhe këtë program. Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të përcaktuara në aktet nënligjore.</p> <p><i>Evidence nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit 2021-2025</i></p> <p><i>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Bankë.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me drejtuesit e FSHE dhe , DKF dhe stafin akademik të programit.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Ky program studimi u jep mundësi studenteve të motivohen në përgatitjen e projekteve të kursit duke u dhënë atyre karakterin e një punimi teorik shkencor por edhe dhe aplikativ. Lendet si "Drejtimi financiar i avancuar" apo " Menaxhim risku" përbejnë një fokus të gjere për ndërmarrjen e punimeve shkencore dhe aplikative.</p> <p>GVJ bazuar në tabelat anekse të RVB evidentoi përfshirje të studenteve të këtij programi në kërkime, projekte dhe aktivitete kërkimore në listën e projekteve ku është përfshirë FSHE . Nga tabelat shihet që numri i studenteve të aktivizuar nga ky program në aktivitete shkencore është 30 nga ku 19 prej tyre janë në kuadër të projekteve të FSHE.</p> <p>Gjate takimeve në institucion u evidentua që studente edhe të programeve të tjera kane marre pjese në konferencën studentore që ka organizuar</p>

	<p>UMSH si dhe në aktivitete kërkimore shkencore në kuadër të projekteve me BE ku institucioni është partner.</p> <p><b>Evidence: Tabela përmbledhëse nr.22</b></p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Bankë.</b></p> <p><b>Vizita e GVJ në institucion; Takim me drejtuesit e FSHE dhe , DFBK dhe stafin akademik të programit</b></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Bazuar në statutin e UMSH, planin financiar për menaxhimin me efektivitet të institucionit si dhe pasqyrave financiare të institucionit, vihet re se, për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore ka mbështetje financiare në kuadër të një buxheti institucional nëpërmjet alokimit të fondeve në fushat e kërkimit shkencor.</p> <p>Gjate vizitës në institucion GVJ evidentoi financim të personelit akademik në botime apo konferenca shkencore kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme të fituara në nivel institucione, por nuk evidentoi një politike të qarte financimi të drejtpërdrejtë nga buxheti në fushën e kërkimit shkencor për stafin e DFBK por vetëm disa raste specifike. Anëtarë të stafit kane pasur financime kryesisht në kuadër të projekteve që ka fituar UMSH.</p> <p><b>Vizita e GVJ në institucion; Takim me stafin akademik dhe pjesëtarë të zyrës se projekteve dhe partneriteteve .</b></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Përsa i përket këtij standardit II.6, GVJ shprehet se:</i></p> <p><i>1. Institucioni duhet të mbështesë në forme financimi të drejtpërdrejtë stafin akademik të DKBF në fushën kërkimore shkencore duke ndertuar politika te qarta financimi me qellim mundesine e një angazhim me efikas të tyre ne kete proces.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		X	

<p><b>Standardi II.7</b></p> <p><b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e</p>	<p>Bazuar në evidencat përkatëse të dhënave të kërkimit shkencor, të dhënat e bashkëpunimeve shkencore në rang fakulteti si dhe nga raportin analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e programit të masterit shkencor “Financë Banke” me profile , u evidentua se, FSHE si njësi përgjegjëse nxiti angazhimin e stafit akademik në projektet kërkimore-shkencore kryesisht nen kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit ose programit ERASMUS si dhe siguron bashkëpunimin</p>





objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. <i>Evidencë nr. 10. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar në strategjinë e kërkimit shkencor të institucionit si dhe në rregulloren e institucionit dhe atë të vetë programit të studimit MSH në "Financë Banke" me profile, theksojmë së njësia përgjegjëse (FSHE) dhe ajo bazë (DFBK), synojnë të angazhojnë stafin akademik dhe studentët në projekte dhe kërkime shkencore. <i>Evidencë nr. 10. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit</i> <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.19</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Bazuar në tabelat anekse të RVB (tabela nr.19 ) shikojmë se FSHE si njësi përgjegjëse e programit nuk ka organizuar konferenca apo aktivitete shkencore. Ky angazhim është realizuar në kuadër të botimeve të stafit akademik në formën e referimeve në konferenca shkencore, pjesëmarrjes në projekte të tillë apo botimin e librave universitare. Për vete kohën e shkurtër të këtij programi nuk evidentohet realizimi i organizimeve kërkimore shkencore në kuadër të tij. Një drejtim tjetër është realizimi i angazhimit të lektorëve të huaj në prezantimin e temave në fushën e programit ku evidentohet që për këtë program kemi pasur angazhimin e 1 lektori të huaj.  <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.2, 19 dhe 20</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Referuar programit të studimit ( që sapo ka diplomuar kontingjentin e pare të studenteve ), përmbajtjes lëndore si dhe studimit të tregut të punës të realizuar në vitin 2021, mendojmë se studentet e diplomuar janë të afte të konkurrojnë në tregun kombëtar dhe sidomos atë lokal të punës.. <i>Evidencë nr.14. Plani mësimor i programit</i> <i>Anekset e RVB. tab.10</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe	NA

rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se programi i studimit garanton njohuri të thelluara në financë si dhe mundësi kërkimi shkencor të suksesshëm, dhe që paraprihen nga një planifikim dhe angazhim serioz i njësisë kryesore dhe asaj baze përgjegjëse të programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Mësimdhënia në programin MSH në “Financë Banke” bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, si dhe në rregulloren e këtij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 12 lëndë dhe 4 module ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Nga numri total i lendeve , 9 klasifikohen të detyrueshme dhe 3 janë lende me zgjedhje.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Bazuar në modelin e programeve të lendeve shikojmë që nota e studentit është e “ndërtuar”, kjo do të thotë që studenti testohet dhe vlerësohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave me shkronja nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara në vlerësime gjate zhvillimit</p>





	<p>lendes (qe për lende të ndryshme varion nga 30% deri 60 % ) dhe në provimin përfundimtar me pjesën tjetër të peshës së vlerësimit.</p> <p>Programi mësimor përfshin realizimin e praktikës dhe vlerësimin final nëpërmjet punimit të mikrotezes</p> <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lende.</p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke.</b></p> <p><b>Evidence nr.14. Plani mësimor i programit të studimit MSH në FB</b></p> <p><b>Evidence nr.14.2..Syllabuset e programit të studimit MSH në FB</b></p> <p><b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kërkues e shkencor të mësimnxënies nga studentët. Në mbështetje të një performace me të mirë mësimdhënieje stafit të programit i kanë shërbyer edhe mobilitetet e realizuara në kuadër të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit.</p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke.</b></p> <p><b>Evidence nr.14.2.Syllabuset e programit të studimit MSH në FB</b></p> <p><b>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik dhe studente të programit</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DFBK rezulton se institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodave pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +. Në kuadër të FSHE gjatë vitit akademik 2022-20223 janë 18 anëtarë të stafit akademik që kanë realizuar mobilitete në kuadër të projekteve ERASMUS .</p> <p>GVJ evidenton se institucioni në vitin akademik 2022-2023 ka një plan trajnimi për stafin akademik me një objekt të gjere dhe tema dhe persona përgjegjës të caktuar paraprakisht.</p> <p>Personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mirandërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes.</p>

	<p>Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Zoom Meeting të cilat ishin dhe metoda kryesore gjate periudhës se pandemisë COVID 19..</p> <p><i>Evidence nr.28. Programi i trajnimeve 2022-2023</i>  <i>Evidence nr.37.Evidenca e lëvizjes të stafit akademik 2022-2023</i>  <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon këtë program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e financës, bankës, kontabilitetit, shërbimeve digjitale financiare si dhe të lendeve të fushave të veprimtarive formuese të tjera .</p> <p>Gjithashtu, metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik, përshkruhen në syllabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit. Seksioni “Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës”, është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuset e lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave.</p> <p>Në vitin akademik 2023-2024 nga 1110 ore mesimore në auditor PAE zhvillon afro 75 % të tyre ndaj 25 % që mbulon PAK, duke plotësuar kriterin përkatës.</p> <p><i>Shtojca nr.14. Plani mësimor i programit të studimit MSH në FB</i>  <i>Shtojca nr.14.2..Syllabuset e programit të studimit MSH në FB</i>  <i>Shtojca nr.14.3.. CV e stafit akademik të programit MSH në FB</i>  <i>Tabelat anekse të RVB. Tabela nr.12.1, 12.2 dhe 12,3</i>  <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentet u evidentua që format tashme të njohura të mësimdhënies nëpërmjet leksioneve , seminareve kane prirje të behën interaktive dhe në forme diskutimi duke përdorur edhe kanalet bashkëkohore të transmetimit të njohurive në funksion të mësimdhënies dhe mesimnxenies.</p> <p>Në kuadër të këtij procesi Njesia e Sigurimit të Brendshem të Cilesise e Zhvillimit të Kurrikules (NJSBCZHK ) e riorganizuar realizon me studentet tërheqjen e mendimit të tyre edhe nëpërmjet pyetësorëve formave të mësimdhënies , vlerësimin e pedagogeve si dhe vlerësimin e lendes. Kjo forme vlerësimi ka qene periodike ka evidentuar dhe vlerësuar situatën e mësimdhënies në institucion.. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në njësinë kryesore (FSHE) dhe atë baze (DFBK ) me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. <i>Nga shqyrtimi i raporteve të NJSBZHC mbi organizimin e pyetësorëve</i></p>




	<p>vërehet një pjesëmarrje relativisht e ulët e studenteve në këtë proces (për këtë program studimi).</p> <p>Bazuar në kërkesën e GVJ gjate vizitës në institucion institucioni plotësoi dosjen e aplikimit me raportin e NJSBCZH për vlerësimin në fokus grup të procesit mësimor në këtë program për semestrin e parë të vitit akademik 2022-2023 ku evidentohet performanca e mësimdhënies dhe mesimnxënies. Pjesëmarrës janë stafi, dhe studente të këtij programi</p> <p>Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në takimet me pedagogun e lendes kryesisht për rritjen e trajtimeve me karakter praktik dhe aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve.</p> <p><b>Evidence shtese. Raport vlerësimi i NJSBCZHK viti 2022-2023</b>  <b>Evidence nr. 18.Rregullore e NJSBCZHK</b>  <b>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit evidentojmë se është realizuar ristrukturimi që në muajin mars 2022 nëpërmjet miratimit dhe operimit të strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni që është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikules (NJSBCZHK), Komisioni i përhershëm i garantimit dhe sigurimit të cilësisë. Këto dy struktura ndjekin dhe vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mesimnxënies të programeve të studimit. Institucioni nuk ka njësi të sigurimit të cilësisë në nivel të njësisë kryesore. NJSBCZHK koordinon punën me njësinë bazë që është DFBK si njësi përgjegjëse e këtij programi.</p> <p>NJSBCZHK monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj</p> <p><b>Mendojmë se realizimi i anketimit të studenteve duhet të realizohet me një pjesëmarrje me të madhe të të gjithë studenteve të MSH në FB. Kjo do të rriste me shume nivelin dhe rëndësinë e kësaj forme vlerësimi.</b></p> <p><b>Evidence nr.18.Rregullore e organizimit të NJSBCZHK</b>  <b>Evidence nr.31. Formular i vlerësimit të pedagogut.</b>  <b>Evidence nr. 32. Plani i monitorimit të DFBK</b>  <b>Evidence shtese. Raport vlerësimi i NJSBCZHK viti 2022-2023</b>  <b>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ vlerëson se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. institucioni garanton realizimin e aftësisë profesionale dhe shkencore me metodat bashkëkohore të mësimdhënies me qendër studentin.</li> <li>2. Programi mësimor i programit përfshin realizimin e praktikës dhe vlerësimin final nëpërmjet punimit të mikrotezes</li> </ol>

	<p>3. Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p>Njwkohsisht, GVJ sugjeron se realizimi i anketimit të studenteve duhet të realizohet me një pjesëmarrje me të madhe të të gjithë studenteve të MSH në FB. Kjo do të rriste me shume nivelin dhe rëndësinë e kësaj forme vlerësimi.</p> <p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e organizimit të UMSH, rregulloren në nivel njësie kryesore dhe baze si dhe rregulloren e këtij programi). Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to'. Më të specifikuarat mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Evidence nr.2. Rregullore e organizimit të UMSH</i>  <i>Evidence nr.8.Rregullore e Departamentit të FBK</i>  <i>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Bankë me profile.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret në nivel institucional, njësi kryesore dhe baze si dhe syllabusin e pedagogëve të studimit programin e studimit MSH në "Financë Banke" dhe vizitës në institucion u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën e parë të mësimin bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit.</p> <p><i>Evidencë nr.14.2.Syllabuset e programit të studimit 2023-2024</i>  <i>Evidence nr.22.Udhezues për studentet</i>  <i>Takimi me stafin akademik gjate vizitës në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar</p>

studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde.  <i>Evidencë nr.14.2.Syllabuset e programit të studimit 2023-2024</i> <i>Evidence nr.22.Udhezues për studentet</i> <i>Takimi me stafin akademik gjate vizitës në institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se: 1. Institucioni ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dijes së studentëve gjatë procesit mësimor. 2. Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të parë të të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve në semestrin përkatës vlerësohen deri në 60 % të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit si dhe testi i ndërmjetëm), ndërsa provimi përfundimtar zë deri 40 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Procesi i realizimit të vlerësimit është trajtuar edhe në rregulloren e programit dhe përfshin edhe aspekte të tjera të tij si sekretimin, kohën e shpalljes së rezultateve, ankimitin e studentet etj.</p> <p>GVJ evidentoi dhe zhvillimin online të procesit mësimor gjate periudhës së pandemisë e paraprirë me rregulloren përkatëse dhe platformat e përdorura në këtë proces.</p> <p><i>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke.</i>  <i>Evidencë nr.14.2.Syllabuset e programit të studimit 2023-2024</i>  <i>Evidence nr.22.Udhezues për studentet</i>  <i>Takimi me stafin akademik gjate vizitës në institucion</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Pothuajse të gjitha vlerësimet e lendeve të programit realizohen me shkrim në baze të modelit të aprovuar të tezes se provimit. Gjatë viteve të fundit UMSH ka filluar të aplikojë sistemin e vlerësimit elektronik dhe ka aplikuar disa vlerësime lëndesh me sistemin elektronik të testimit (<i>Projekti clean score</i>). Në këtë program ky lloj vlerësimi ende nuk është aplikuar. GVJ sugjeron përdorimin e testimit elektronik si një mundësi që shmang format e abuzimit dhe rritin transparencën.</p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke.</b>  <b>Evidencë nr.14.2.Syllabuset e programit të studimit 2023-2024</b></p> <p><b>Shtojca nr.5. Rregullore e programit të studimit MP në Financë Takim gjatë vizitës në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e vlerësimit përfundimtar të dijeve të studentëve DFBK, bazuar në rregulloret përkatëse në nivel institucional dhe të vetë këtij programi, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DFBK.</p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke.</b>  <b>Evidence nr.40. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DFBK. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Format i tezes se provimit ka si seksion me vetë komentet e pedagogut për përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezes është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve.</p> <p><b>Evidence nr.8.Rregullorja e DFBK</b>  <b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në Financë Banke</b>  <b>Vizita në institucion e GVJ ( pranë sekretarisë mësimore)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentet e programit evidentohet korrektësia e zhvillimit të provimit si me monitorimin nga dy pedagoge anëtarë të komisionit ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit. Moslejimi i plagjiaturës apo kopjimi gjatë provimit janë të</p>




	<p>sanksionuar në rregulloren e njësisë kryesore FSHE (neni 49) dhe njësisë baze DFBK (neni 21 dhe 22 )</p> <p><b>Evidence nr.7.Rregullorja e FSHE (neni 49)</b></p> <p><b>Evidence nr.8.Rregullorja e DFBK (neni 21 dhe 22)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjate takimeve me stafin akademik dhe studentet evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës se parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimevetë provimeve bëhet brenda 7 ditëve nga data e zhvillimit të tyre brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese (nga takimi me stafin akademik). Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshim pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p> <p><b>Evidence nr.7.Rregullorja e FSHE</b></p> <p><b>Evidence nr.8.Rregullorja e DFBK</b></p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSh në Financë Banke</b></p> <p><b>Vizita në institucion e GVJ ( me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit studenti ka 3 dite kohe pas shpalljes se rezultatit të vlerësimit që të beje ankese nëse ai ka pretendime për një vlerësim me të lartë. Institucioni ka model formulari tip për ankimimin e studentit. Atij i jepet mundësia të ballafaqohet me pedagogun e lendes dhe vlerësimin e bere si dhe i jepet përgjigja edhe e shkruar në formular. Nga takimi me studentet e këtij programi gjate vizitës në institucion ata nuk kishin pasur praktike të tille. Reklamimi për vlerësimin nuk kishte shkruar në këtë faze pasi ishte zgjidhur gjate takimit që pedagogu i lendes zhvillon me studentet në datën e paracaktuar para se të hedhe vlerësimet përfundimisht në sistem.</p> <p><b>Evidence nr.7.Rregullorja e FSHE</b></p> <p><b>Evidence nr.8.Rregullorja e DFBK</b></p> <p><b>Evidence nr.9. Rregullore e programit të studimit MSh në Financë Banke</b></p> <p><b>Vizita në institucion e GVJ ( me stafin akademik dhe pranë sekretarisë mësimore)</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente</p>	<p>Në rast të kërkesës për ankimim që bën studenti sipas formularit të miratuar pasi është ezauruar takimi me pedagogun e lendes dekani në bashkëpunim me përgjegjësin e DFBK ngre një komision ad-hok për rivlerësim të provimit. Në përfundim të vlerësimit Komisioni jep vendimin final duke e bere transparente procesin me studentin dhe</p>

për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	pedagogun e lendes përkatëse. Për këtë program në nuk evidentuam praktika të tilla. <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Duke ndjekur procedurat e vlerësimit të dijeve arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studenteve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimit nga studentet dhe zgjidhjes së saj.</li> <li>2. Institucioni ka ngritur rregullore në funksion të realizimit të procesit të vlerësimit të dijeve.</li> <li>3. GVJ sugjeron përdorimin e testimit elektronik si një mundësi që shmang format e abuzimit dhe rritin transparencën.</li> </ol> GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.4</b> <b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Bazuar në planin mësimor, programi i studimit MSH në “Financë Banke”, bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit në Financë dhe garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e financës, bankës dhe teknologjisë financiare. Mbështetur në module që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të që në semestrin e parë, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik, profesional dhe relativisht edhe atë shkencor të studentëve. <i>Bazuar edhe në vlerësimet e mësipërme mendojmë që në profilin “Teknologjitë e reja financiare” të përmirësohet me tej ky profil në funksion të objektit mësimor shkencor që ai ka dhe që lidhet edhe me intensitetin e përparimeve teknologjike në shërbimin financiar.</i>  <i>Evidence nr.5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSH në FB</i> <i>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit MSH në Financë Banke Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe	Bazuar në programin e studimit MSH në “Financë Banke” me profile , si dhe syllabuseve të lëndëve shikohet se zhvillohen aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në një numër

<p>ndërveprimi (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>lëndësh të këtij programi. Lende të tilla si “ Metodat e kërkimit shkencor” , “Menaxhim strategjik i IF “ apo “Kreditim dhe Analize kredie” në të cilat përdoren dhe programet aplikative kompjuterike rrisin me tej aftësinë e përdorimet të teknologjisë se informacionit, komunikimin dhe ndërveprimin si aspekte të rëndësishme të fitimit të dijeve në këto fusha.</p> <p><b>Evidencë nr.14.Plani mësimor i programit/Aneksat e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregulloret e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr.14.2. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë Bankë.</b>  <b>Takimi me stafin akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit/seminarit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit). Përfitimet e marrjes se njohurive shihen të lidhura ngushte edhe me mundësinë e aplikimit të tyre në pozicione të ndryshme të punës në sektorin e financës.</p> <p><b>Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarët e tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar kjo realizohet në lëndët e “Metoda kërkimi shkencor”, “Drejtim i avancuar financiar”, “Standardet ndërkombëtare në kontabilitet”, etj, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator.</p> <p>Eksperienca e stafit akademik si dhe mobilitetet e realizuara prej tyre në kuadër të programit ERASMUS+, apo pjesëmarrës në projektet kërkimore mundësojnë rritjen e nivelit të mësimdhënies.</p> <p><b>Evidencë nr.14 .Plani mësimor i programit/Aneksat e RVB.tab.10</b>  <b>Evidencë nr.9.Rregulloret e programit MSH në Financë Bankë</b>  <b>Evidencë nr14.2. Syllabuset e lendeve të programit MSH në Financë Bankë.</b>  <b>Takimi me stafin akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>UMSH ka një traditë të pasur në zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete të fushave të ndryshme, të cilat realizohen kryesisht në rang institucional. në FSHE dhe DFBK organizojnë leksione të hapura me studentet e këtij program duke ftuar personalitete apo specialiste të</p>



teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	mirënjohur në këtë fushë me trajtimin e temave të financës apo riskut në ekonomi. Në takimin me studentet e programit ata konfirmuan pjesëmarrje në leksione të hapura që janë zhvilluar në FSHE.  <b>Evidence nr.17.Leksione të hapura në DFBK</b> <b>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjate realizimit të praktikës. <b>Vizita në institucion dhe takime me stafin akademik dhe studentet</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ eidenton se programi i studimit garanton dhënien e njohurive të gjera teorike shkencore dhe aplikative me tipare të një programi mësimor të nivelit të dyte MSH.</i> <i>Njëkohësisht, në vijim të rritjes së cilësisë të programit të studimit, GVJ konstaton se ka hapësirë për përmirësim në profilin "Teknologjitë e reja financiare" duke përfshirë më shumë njohuri të lidhura me përparimet teknologjike në shërbimin financiar.</i>  <i>Përsa i përket standardit III.4, GVJ shprehet se përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit (neni 24) dhe rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës si një dokument me vete. Paraprakisht studentet informohen për fushat e ekspertizës se stafit dhe temat orientuese që ata ofrojnë për studentët. Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët.  <b>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</b> <b>Evidence nr. 11.Fushat e ekspertizës dhe temat e diplomës</b> <b>Evidenca nr.21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</b>




	<i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblylëse.	<p>DFBK, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët nëpërmjet dokumentit të fushave të ekspertizës së pedagogëve dhe temat e mundshme të diplomimit që ata mbulojnë, plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DFBK përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. në ndihme të studenteve për këtë qëllim organizohet seanca metodologjike në auditor ku jepen udhëzimet përkatëse për përgatitjen e punimit përmblylës.</p> <p><i>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</i>  <i>Evidence nr. 11.Fushat e ekspertizës dhe temat e diplomës</i>  <i>Evidenca nr.21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>  <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p>Te gjithë studentet e këtij programi e përmbyllin programin me përgatitjen e një punimi diplome. Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili bën vlerësimin e punimit të mikrotezes bazuar në :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësim gjatë vitit akademik;</li> <li>• Përdorimi i metodologjisë shkencore të punimit;</li> <li>• Origjinaliteti i punimit</li> <li>• Dobia e punimit</li> <li>• Cilësia e të shkruajturit</li> <li>• Paraqitja teknike</li> <li>• Cilësia e prezantimit</li> <li>• Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës;</li> </ul> <p><i>Evidencë nr.9.Rregullore e programit MSH në Financë Bankë</i>  <i>Evidencë nr. 21. Udhëzues i punimit të diplomës</i>  <i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me stafin akademik dhe studentet e programit</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DFBK miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së</p>

<p>përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.</p> <p>Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbjlljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara.</p> <p><i>Evidence nr. 11. Fushat e ekspertizës dhe temat e diplomës</i></p> <p><i>Evidenca nr.21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ; takimi me studentet e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekë dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.</p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në komponentët e vlerësimit të përcaktuara në formularin përkatës dhe të plotësuar nga pedagogu udhëheqës i punimit si dhe vlerësimin nga prezantimi i punimit para tyre bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare dhe i behet të ditur studentit në fund të seancës së mbrojtjes.</p> <p><i>Evidencë nr.9. Rregullore e programit MSH në FB</i></p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR sipas profilit që ata kane zgjedhur. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2022-2023. Në rast se studenti kërkon dhe kopje të programit të studimit me përmbajtjen lëndore me kërkesën e tij ai pajiset me këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar në rregullore kundrejt pagesës së tarifës.</p> <p><i>Evidencë nr.26. Suplement diplome të programit MSH në FB me profile</i></p>

	<p><b>Evidenca nr.9. Rregullore e programit të studimit MSH në FB me profile.</b></p> <p><b>Evidencë nr.49. Modeli i diplomës MSH në FB</b></p> <p><b>Takim në sekretarinë e institucionit</b></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.</p> <p><b>Evidencë nr. 1.27.Rregullore e sekretarisë mësimore</b></p> <p><b>Takim në sekretarinë e institucionit</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. Institucioni ka një procedure të qarte të detyrimeve përmbyllëse të standarteve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit.</i></li> <li><i>2. Institucioni mbështet studentët në procesin e përfundimit të programit të studimit dhe në fazën e diplomimit.</i></li> </ol> <p><i>GVJ vlerëson ky standard plotësohet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b>  <b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>NA</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>NA</p>

<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të	Bazuar në informacionin e paraqitur në raportin e vetëvlerësimit (RVB), dokumentacionin shoqërues të RVB-së, si dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, GVJ konstaton se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UMSH.  Programi i studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" ofrohet nga Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet.


<p>programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në këtë program studimi, referuar Tabelës përmbledhëse- Tabela 6.1; 6.2; 6.3, të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Për vitin akademik <b>2023-2024</b> janë angazhuar <b>12</b> personel akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>9 PAE</b>, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, dhe 6 me gradën “Doktor”;</li> <li>• <b>3 PAK</b>, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, dhe 1 me titullin “Profesor i Asocuar”.</li> </ul> <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin <b>75% nga PAE.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2022-2023</b> janë angazhuar <b>12</b> personel akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>9 PAE</b>, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, dhe 6 me gradën “Doktor”;</li> <li>• <b>3 PAK</b>, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, dhe 1 me titullin “Profesor i Asocuar”.</li> </ul> <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin <b>75% nga PAE.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022</b> janë të angazhuar <b>8</b> personel akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>8 PAE</b>, nga të cilët 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 6 me gradën “Doktor”;</li> </ul> <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin <b>100% nga PAE.</b></p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik dhe dokumentave të tjera plotësuese të stafit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë, nr. 80, 2015, neni 59) për nivelin e kualifikimit (PAE dhe PAK që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi) në lidhje me gradat shkencore. Nga shqyrtimi i CV-ve dhe fushës së ekspertizës, GVJ konstaton që personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 14.3 CV e stafit akademik të programit të studimit MSCFB me profile.pdf</i>  <i>Evidenca 11. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese DFBK 2022-2023.pdf</i>  <i>Tabela FB.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për</p>	<p>GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik efektiv në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke plotësuar kushtet e kërkuara nga Ligji i Arsimit të Lartë për të dhënë</p>



<p>programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë. Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me personel akademik efektiv. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të të paraqitur, tabelave përmbledhëse të programit dhe të departamentit përgjegjës për programin, u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për dy vite akademike të fundit është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="638 465 1385 667"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>1155</td> <td>870</td> <td>285</td> <td>75%/25%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>1155</td> <td>870</td> <td>285</td> <td>75% / 25%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidence RVB, tabelat përmbledhëse tabela nr.6.1 dhe 6.2</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	1155	870	285	75%/25%	2023-2024	1155	870	285	75% / 25%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
2022-2023	1155	870	285	75%/25%												
2023-2024	1155	870	285	75% / 25%												
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" që ofrohet nga Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet. Kontratat e punësimit pranë UMSH dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi pothuaj nuk ka ndryshuar.</p> <p><i>Tabela FB.pdf</i>  <i>Evidenca 33 Kontrata e punës tip PAE.pdf</i>  <i>Evidenca 33.1 Kontrate e Punes tip PAK.pdf</i></p>															
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë për zgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UMSH, që bazohet në këtë kuadër ligjor. Në statutin e UMSH janë të përcaktuara kriteret e punësimit të personelit akademik (neni 57 dhe 58), si dhe ndihmës akademik (neni 59), ndërsa në Rregulloren e organizimit të UMSH janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e rekrutimit (Kreu V, neni 39-40)</p> <p>Rekrutimi i personelit, bëhet me konkurrin të hapur. UMSH shpall konkursin për vend të lirë pune, pas kërkesës së Departamentit të Financë Bankë Kontabilitet, bazuar në nevojat e këtij të fundit. Njësia bazë përcakton kriteret specifike në lidhje me nivelin e duhur të kualifikimit në përputhje me modulet ku planifikohet të angazhohet kandidati për vendin e lirë të punës, të cilat miratohen nga rektori. Universiteti shpall konkursin për vende të lira pune, duke e publikuar në faqen zyrtare web të UMSH. Për realizimin e procesit të rekrutimit ngrihet një komision ad-hoc pranë njësisë bazë, i kryesuar nga Dekani i</p>															

	<p>fakultetit përkatës. Ky proces realizohet në dy faza: faza e parë përfshin vlerësimin e dosjes së aplikonit dhe faza e dytë intervistën. Komisioni bën vlerësimin e kandidatëve. Komisioni i paraqet rektorit raportin e procesit. Kontrata e punësimit lidhet nga rektori i UMSH. Procesi është i njëjtë edhe për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Dokumentacioni i procesit ruhet në Zyrën e Burimeve Njerëzore të UMSH.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 33 Kontrata e punës tip PAE.pdf</i>  <i>Evidenca 33.1 Kontrate e Punës tip PAK.pdf</i>  <i>Evidenca 29. Procedura e rekrutimit të stafit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në Institucion, konstaton përshtatshmërinë e mjediseve dhe infrastrukturës në dispozicion për mbarëvajtjen e programit të studimit. Informacioni i paraqitur në RVB sqaron angazhimin e stafit akademik në moderimin e infrastrukturës mësimore. Sipas rregullores së programit të studimit (Neni 11), personeli ndihmës mësimor asiston në aspektet logjistike të lidhura me procesin mësimor.</p> <p>Bazuar ne dokumentacionin shtesë kërkuar nga GVJ gjate vizitës ne institucion evidentohet se pranë DFBK janë te atashuar dy punonjës staf ndihmës qe zotërojnë diplomën Master i Shkencave.</p> <p><i>Evidenca 27. Relacioni i verifikimit të Godines.pdf</i>  <i>Evidenca 9. Rregullore Programit të studimit MSH në FB me profile _BTF_TRF.pdf</i>  <i>Evidenca shtesë pas vizitës ne institucion mbi personelin e DFBK gjate dy viteve te fundit akademike</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në UMSH, GVJ konkludon se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit është Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjatë vizitës pranë kësaj strukture, GVJ konstatoi se Zyra e Burimeve Njerëzore mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe i përditëson ato rregullisht mbi bazë vjetore. Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, përkatësisht një PAE dhe një PAK, GVJ konstatoi plotësinë e tyre. Përmbajtja e dosjes së personelit akademik: kontratë individuale; raport mjekësor; diploma (bachelor, master, etj., si dhe listat e notave shoqëruese); dëshminë e penaltetit; CV; certifikate mbrojtje e gjuhës së huaj, si edhe dokumenta të tjerë plotësues kryesisht të lidhura me kualifikime shkencore dhe akademike.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UMSH në nivel Institucional ka nënshkruar një numër të lartë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor. Programi i studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" ka pjesë të kurrikulës zhvillimin e praktikës profesionale gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë.</p> <p>Departamenti i Financë Bankë Kontabilitet cakton një personel akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e studentit gjatë praktikës mësimore (Kreu VIII, neni 48, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike). Gjithashtu në institucionin ku zhvillohet praktika, studentit i caktohet një person mbikëqyrës për realizimin me sukses të praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës studenti përpilon një relacion për punën e kryer, së bashku me një vërtetim të nënshkruar nga titullari i institucionit ku është realizuar praktika. Relacioni i dorëzuar vlerësohet me notë nga komisioni i ngritur në departament.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, është i angazhuar për të asistuar studentët për të përgatitur tezën e diplomës. Për çdo student departamenti përcakton një staf akademik, drejtues të punimit shkencor (Kreu X, neni 52, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike). Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga komisioni i ngritur në departament.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH u ofron studentëve të këtij programi mbështet departamentin në lidhje me mundësitë për realizimin e praktikave mësimore, nëpërmjet aktiviteteve të saj. Gjithashtu gjatë takimit me studentët, doli në pah që informacion në lidhje me mundësinë për zhvillimin e praktikave mësimore (profesionale) për ata studente që nuk janë të punësuar ju ofrohen si nga zyra e karrierës, ashtu edhe nga stafi akademik që është i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <i>Evidenca 13. Udhëzim për Praktikën dhe formularët tip të praktikës mesimore.pdf</i>  <i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" ka pjesë të kurrikulës zhvillimin e praktikës profesionale gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë.</p> <p>Në përfundim të praktikës mësimore, bazuar në Udhëzuesin për praktikën, studentit dorëzohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formularin e vlerësimit nga pedagogu mbikëqyrës;</li> <li>- Formularin e vlerësimit nga mbikëqyrësi në kompaninë/institucionin ku zhvillon praktikën;</li> </ul>




<p>në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportin përfundimtar (relacion) të përgatitur nga studenti për punën e kryer gjatë praktikës.</li> </ul> <p>Si pedagogu mbikëqyrës, ashtu edhe mbikëqyrësi në kompani/institucion angazhohen në rritjen e nivelit profesional të studentëve dhe në përfundim të praktikës bëjnë vlerësimin e studentit. Në përfundim të praktikës mësimore, studenti vlerësohet me notë.</p> <p><b><i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i></b>  <b><i>Evidenca 13. Udhëzim për Praktikën dhe formularët tip të praktikës mesimore.pdf</i></b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për nivelin e duhur profesional për natyrën dhe modulet e këtij programi.</li> <li>- Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me PAE. Stafit i angazhuar në këtë program studimi është shumë i qëndrueshëm, referuar si PAE, ashtu edhe PAK.</li> <li>- Institucioni ndjek procedurat e duhura të rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik, duke përcaktuar kritere specifike në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij program studimi. Të dhënat e stafit ruhen konform të gjitha detyrimeve ligjore, si dhe përditësohen rregullisht.</li> <li>- Institucioni ka nënshkruar një numër marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private. Zyra e karrierës si dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, mundësojnë zhvillimin e praktikës mësimore profesionale, duke u siguruar që mbikëqyrësi në vendin e praktikës të angazhohet në rritjen e nivelit profesional të studentit.</li> <li>- Çdo student mbyll ciklin e studimeve në të këtë program duke përgatitur një tezë diplome. Departamenti i Financë, Banke, Kontabilitet, cakton një personel akademik për të asistuar studentin në përgatitjen e tezës së diplomës. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga komisioni i ngritur në këtë departament.</li> <li>- Bazuar në dokumentacionin shtesë kërkuar nga GVJ gjatë vizitës në institucion evidentohet se pranë DFBK janë të atashuar dy punonjës staf ndihmës që zotërojnë diplomën Master i Shkencave.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>






<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB-së, UMSH zhvillon procesin mësimor në një mjedis me infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi ambiente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare", duke konsideruar kurrikulën e programit dhe numrin e studentëve. Infrastruktura në funksion të procesit mësimor në UMSH përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 6 Salla leksionesh</li> <li>• 17 Salla Seminaresh</li> <li>• 2 Laboratorë</li> <li>• 117 Kompjuteri</li> <li>• 15 Projektorë</li> </ul> <p><i>Evidenca 27. Relacioni i verifikimit të Godines.pdf</i>  <i>Evidenca 42. Urdhër për Higjienën dhe zjarrin.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas kërkesave të programit të studimit. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, duke ju lehtësuar pedagogëve dhe studentëve procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në takimin me studentë u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve edhe gjatë procesit të realizimit të detyrave të kursit dhe punimit të tezës së diplomës.</p> <p>Zyrat e mjediset e personelit akademik dhe ndihmës akademik janë të përshtatshme dhe të pajisura me mjete dhe pajisje që mundësojnë realizimin e detyrave dhe përgjegjësisive akademike.</p> <p>Infrastruktura lejon lëvizjen dhe aksesin edhe personave me aftësi të kufizuara.</p> <p><i>Evidenca 27. Relacioni i verifikimit të Godines.pdf</i>  <i>Evidenca 20. Rregullore për studentet me aftësi ndryshe.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë bashkëkohore. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, ku janë instaluar programe të ndryshme, që ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor</p>



moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	të studentëve, duke plotësuar edhe objektivat kryesore të këtij program studimi. <i>Evidenca 27. Relacioni i verifikimit të Godines.pdf</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Relacioni i verifikimit të godinës përcakton praninë e dy laboratorëve. Sipas RVB dhe pas vizitës në institucion, GVJ konstatoi përshtatshmërinë e laboratorëve, të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programet bazike të Windows 7, Microsoft Office, dhe programe specifike aplikative financiare si “Financë 5” dhe “Alpha Web”, dhe të gjuhëve të huaja si: “Exceller”, “T-Translator”, “GINGER”, që ndihmojnë në aftësimin praktik të studentëve. <i>Evidenca 27. Relacioni i verifikimit të Godines.pdf</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	GVJ konstaton se praktikat profesionale kryehn në bashkëpunim me institucione publike dhe private, në mjediset e punës të këtyre të fundit. Nuk ka evidenca që praktikat profesionale të zhvillohen në mjediset e institucionit. Për vetë natyrën e programit të studimit, zhvillimi i praktikave pranë bizneseve apo institucioneve publike gjykohet i përshtatshëm. <i>Evidenca 13. Udhëzim për Praktikrat dhe formularët tip të praktikës mesimore.pdf</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> - Institucioni ofron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtij program studimi. - Mjediset mesimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program.  Laboratorët mesimorë janë të pajisur me programe dhe software të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi IV.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-13423


Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)




<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi që për të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi vihet në dispozicion të studentëve literaturë kryesisht në gjuhën e programit (shqip), por ka edhe lëndë që ofrojnë literaturë të detyrueshme si në gjuhën shqip, edhe në gjuhën angleze, ashtu si edhe lëndë që ofrojnë literaturë të detyrueshme vetëm në gjuhën angleze. Ndërkohë literatura ndihmëse ofrohet si në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj. Literatura në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze) ofrohet në formë fizike dhe digjitale pranë bibliotekës së këtij Institucioni. GVJ konstaton se literatura është përgjithësisht e përshtatshme për lëndët e programit të studimit, duke siguruar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në program.  <i>Evidenca 14.2.1 Syllabuse 2023-2024 vitit pare BTF, TRF.pdf</i> <i>Evidenca 14.2.2 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte BTF.pdf</i> <i>Evidenca 14.2.3 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte TRF.pdf</i> <i>Evidenca 43. Material per biblioteken.pdf</i> <i>Vizita e GVJ në ambientet e bibliotekes</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB konkludon se literatura bazë jo gjithmonë është e përditësuar me botime të viteve të fundit. Këtu ndikon edhe fakti që duke pasur numër të ulët studentësh në nivelin Master, ribotimi i librave bëhet në periudha më të gjata kohe.  Gjithsesi GVJ bazuar në informacionin dhe dokumentat shoqërues të RVB, si dhe vizitës në institucion, konstaton ecurinë në drejtim të pasurimit të bibliotekës fizike dhe digjitale në UMSH. Konkretisht praktika e Departamentit dëshmon përditësimin e fondit të librave mbi bazën e kërkesave të pedagogëve në përputhje me nevojat e programit të studimit. Gjithashtu, konstatohet pasurimi i bibliotekës elektronike me tituj dhe burime literature në dispozicion të stafit dhe studenteve pjesë e programit të studimit.  <i>Evidenca 43. Material për biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 44. Kërkesë për libra DFBK.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UMSH vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi bibliotekën.  <i>Vizita e GVJ në ambientet e bibliotekës</i>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si:	Nga vizita në këtë bibliotekë dhe informacioni i marrë më pas, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të

<p>tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të institucionit, si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj; botime e monografi; e cila mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit. Gjithashtu në dispozicion të stafit dhe studentëve të programit të studimit, është edhe fondi elektronik i librave dhe burimeve të tjera të literaturës pjesë e bibliotekës elektronike të institucionit.</p> <p><b>Evidenca 43. Material për biblioteken.pdf</b> <b>Vizita e GVJ në ambientet e bibliotekës</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton dhe vlerëson që UMSH është pjesë e EIFL (Electronic Information for Libraries) për përdorimin e platformës elektronike Edward Elgar Publishing, nëpërmjet Shoqatës së Bibliotekave të Shqipërisë e cila përfaqësohet nga Biblioteka e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Kjo platformë elektronike (Edward Elgar Publishing), ofron libra dhe revista elektronike për të gjitha programet e studimit në UMSH. Biblioteka e Universitetit Mesdhetar, është bërë anëtare e COBISS me të drejta të plota në 01.02.2022. COBISS.net është një projekt i cili mirëmbahet, e përditësohet nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM) Maribor, Slloveni. Studentët kanë mundësi të kërkojnë dhe aksesojnë libra, artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit, si dhe moduleve të këtij programi studimi. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, që është shtuar në mënyrë të konsiderueshme numri i titujve online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe inovative në këtë proces mësimor-kërkimor.</p> <p><b>Evidenca 43. Material për biblioteken.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës dhe konstatoi që salla e bibliotekës ka fondin e librave dhe burime të tjera të literaturës të aksesueshëm nga çdo kompjuter që ndodhet në bibliotekë. Kompjuterat janë të lidhur me internetin, gjë që mundëson aksesin në materiale të tjera elektronike. GVJ iu konfirmua nga punonjësi i bibliotekës dhe studentët, se biblioteka frekuentohej vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore por edhe si sallë studimi. Fondet e librave janë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve pa pagesë.</p> <p>Në dokumentacionin e aplikimit evidentohet dhe kërkesa e DFBK drejtuar administratorit për blerje literature në fushën e financës.</p> <p><i>Megjithatë GVJ sugjeron që institucioni duhet të shtojë më shumë fondin fizik dhe online të librave me autor të huaj në fushën e financës bankës dhe sidomos pasurimin e saj me literaturën bashkëkohorë të financave digjitale që përbën dhe një nga profilet e këtij programi studimi.</i></p> <p><b>Evidenca 43. Material për biblioteken.pdf</b> <b>Evidenca nr.44.Kerkese për libra nga DFBK</b></p>

	<b><i>Vizita e GVJ në ambientet e bibliotekës</i></b>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Referuar RVJ dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se biblioteka ofron shërbimet për studentët në orare që përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, për këtë program studimi.  <b><i>Vizita e GVJ në ambientet e bibliotekës</i></b>
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Referuar RVB, institucioni informohet për nevojat për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me titujt të rinj në mbështetje të programeve të studimit. Megjithatë nga vizita në institucion u konstatua që pasurimi i fondit fizik ka qenë i kufizuar.  Regjistrimi në disa platforma elektronike (biblioteka online) ofron mundësinë për përditësim literature digjitale për studentët. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, shtimin e numrit të titujve online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe inovative në këtë proces mësimor-kërkimor.  Një pjesë e titujve të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës janë botime të personelit akademik të UMSH, si tekste mësimore dhe libra të tjerë, ose botime të UMSH Press apo punime shkencore të botuara në revistat e UMSH.  <b><i>Evidenca 43. Material për biblioteken.pdf</i></b>
<b>Konkluzione</b>	<b><i>GVJ konstaton se:</i></b>  <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë në gjuhën e programit dhe shpesh edhe në gjuhë të huaj, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj për të gjitha lëndët e kurrikulës.</li> <li>- Biblioteka fizike dhe online vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagesë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi.</li> <li>- Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike.</li> </ul> <p>Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse bëhet kryesisht nëpërmjet platformave online. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, shtimin e numrit të titujve fizikë dhe online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe inovative në këtë proces mësimor-kërkimor.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka sistemin e menaxhimit të studentëve (SMS) nëpërmjet të cilit shkëmbehet informacioni i nevojshëm mes studenteve dhe personelit akademik. Edhe nga takimi me studentet që GVJ evidentoj aksesi të tyre në marrjen e ndërsjellët të informacionit prej tyre lidhur me procesin e mësimdhënës dhe mësim nxënies. Studentet kanë llogarinë personale në këtë sistem dhe sistemi i informatizuar u mundëson marrjen e informacionit të nevojshëm .</p> <p>Ndërkohë sekretaria mësimore është struktura që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë vizitës në sekretari GVJ-ja verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit Master në Bankë-Financë dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. GVJ evidentoi që të dhënat mbahen dhe përditësohen elektronikisht, gjithashtu edhe në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. GVJ verifikoi dhe hedhjen e të dhënave personale të studentëve në regjistrin e amzës (regjistri themeltar). I gjithë informacioni ruhet në formë të përpunueshme në programet bazë për analiza të hollësishme. UMSH i ruan të gjithë rregjistrat në formë të shkruar dhe në version elektronik, në administrimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformave elektronike.pdf</i> <i>Takim i GVJ me student</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, Rregullores së UMSH (Kreu IV, Neni 38) dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në formën e dosjes personale të personelit, si dhe Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet përgjegjës për këtë program studimi.</p>




	<p>Sistemi i menaxhimit të studentëve lehtëson ruajtjen e informacionit dhe dokumentacionit në funksion të veprimtarisë akademike dhe administrative. Regjistrat e lëndëve dhe procesverbalet e provimeve ruhen nga sekretaria mësimore.</p> <p><b>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</b> <b>Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformave elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Institucioni dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UMSH, GVJ-ja konstatoi se sistemi i menaxhimit të studentëve është i organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë.</p> <p><b>Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformave elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se sistemi i menaxhimit të studentëve i vënë në funksionim që në vitin 2017 është i organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Përdorimi edhe i platformave online G-Suite dhe Zoom Meeting, nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim material, si dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><b>Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformave elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>GVJ konstaton se në tërësi sistemi i menaxhimit të UMSH bëhet në mënyrë të dokumentuar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><b>Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformave elektronike.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Pas konsultimit të website të UMSH, GVJ konstatoi se janë bërë publike informacione që lidhen me programin e studimit, njësinë bazë që ofron programin e studimit, personelin akademik, si dhe një sërë informacionesh dhe aktivitetesh të tjera publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqip dhe anglisht.</p> <p><b>Referenca: <a href="http://www.umsh.edu.al">www.umsh.edu.al</a></b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b>GVJ konstaton se:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</li> <li>- Sistemi i menaxhimit ka të integruar disa platforma të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe</li> </ul>

	shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Informacionet në website e UMSH-së publikohen në dy gjuhë, dhe informacioni është lehtësisht i aksesueshëm.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitën në institucion konstatoi se UMSH harton planin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Çdo njësi bazë përgatit projekt buxhetin bazuar në nevojat për mbulimin e programeve të studimit që ofron. Bazuar në këto projektbuxhete hartohet projekt buxheti për institucionin, në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të tij.  <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 19.1 Tabela e të dhënave financiare 2017-2022.pdf</i> <i>Evidenca 19.2_19.3 Pasqyrat financiare Raporti i Auditimit.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Mbështetur në statutin e UMSH, projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet në përputhje me propozimet e bëra prej njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe në zbatim të planit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bordi i Administrimit dhe Senati. Në raportet financiare shpenzimet janë të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre, ndërsa të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve të parashikuara të financimit: të ardhura nga tarifata, të ardhura nga projektet, të ardhura nga burime të tjera.  <i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 19.1 Tabela e të dhënave financiare 2017-2022.pdf</i> <i>Evidenca 19.2_19.3 Pasqyrat financiare Raporti i Auditimit.pdf</i>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni auditohet çdo vit nga një Kompani Auditimi e çertifikuar, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Pasqyrat Financiare, raportet që lidhen me to, si dhe raportet e auditit sikundër përcaktuar nga legjislacioni në fuqi janë publike.</p> <p><b>Evidenca 19.1 Tabela e të dhënave financiare 2017-2022.pdf</b>  <b>Evidenca 19.2_19.3 Pasqyrat financiare Raporti i Auditimit.pdf</b></p>									
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitën në institucion konstatoi se UMSH harton planin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Çdo njësi bazë përgatit projekt buxhetin bazuar në nevojat për mbulimin e programeve të studimit që ofron. Bazuar në këto projektbuxhete hartohet projekt buxheti për institucionin, në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të tij.</p> <p><b>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</b>  <b>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</b></p>									
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB dhe dokumentave shoqëruese, RVJ konstaton se të ardhurat e UMSH janë të klasifikuara sipas burimeve të parashikuara të financimit: të ardhura nga tarifata, të ardhura nga projektet, të ardhura nga burime të tjera.</p> <p>Nga shqyrtimi i informacionit mbi buxhetin paraqitur në dokumentacionin shoqërues të RVB, dhe duke analizuar Pasqyrat Financiare, dhe raportet që lidhen me to, si dhe raportet e auditit sikundër përcaktuar nga legjislacioni në fuqi GVJ konstaton qëndrueshmërinë dhe mjaftueshmërinë financiare të Institucionit. Nga analiza konstatohet se UMSH ka kapacitete financiare dhe gjeneron të ardhura, me të cilat plotëson të gjitha standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktivitetit.</p> <p>Megjithatë, në dokumentat shoqëruese nuk ka një raport mbi analizën afatgjatë të qëndrueshmërisë financiare të Institucionit. <u>GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare, për këtë program studimi dhe Departamentin e Financë- Kontabilitetit.</u> Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi paraqitet në tabelën e mëposhtme.</p> <table border="1" data-bbox="639 1608 1254 1854"> <thead> <tr> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> <th>2023-2024</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>40 (Profili Teknologjite e reja financiare)</td> <td>50 (Profili Teknologjite e reja financiare)</td> <td>50 (Profili Teknologjite e reja financiare)</td> </tr> <tr> <td>97 (Profili Banka dhe</td> <td>80 (Profili Banka dhe</td> <td>45 (Profili Banka dhe</td> </tr> </tbody> </table>	2021-2022	2022-2023	2023-2024	40 (Profili Teknologjite e reja financiare)	50 (Profili Teknologjite e reja financiare)	50 (Profili Teknologjite e reja financiare)	97 (Profili Banka dhe	80 (Profili Banka dhe	45 (Profili Banka dhe
2021-2022	2022-2023	2023-2024								
40 (Profili Teknologjite e reja financiare)	50 (Profili Teknologjite e reja financiare)	50 (Profili Teknologjite e reja financiare)								
97 (Profili Banka dhe	80 (Profili Banka dhe	45 (Profili Banka dhe								

	Tregje Financiare)	Tregje Financiare)	Tregje Financiare)	
	<p>Duke vërejtur uljen e numrit të studentëve në profilin Banka dhe tregje financiare, si dhe duke vërejtur që burimi kryesor i të ardhurave përgjatë 3 viteve akademike të cilësuar janë të ardhurat nga tarifat (83%, 89%, 84%), <i>GVJ konsideron të nevojshme analizën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë të institucionit.</i></p> <p><i>Evidenca 19.1 Tabela e të dhënave financiare 2017-2022.pdf</i>  <i>Evidenca 19.2_19.3 Pasqyrat financiare Raporti i Auditimit.pdf</i>  <i>tabela FB.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UMSH auditohet çdo vit nga një Kompani Auditimi e certifikuar, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara.</li> <li>- UMSH ka patur qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</li> </ul> <p><i>Megjithatë, meqë nuk konstatoam një analizë afatgjatë të qëndrueshmërisë financiare të institucionit, GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare si për Institucionin, por edhe për Departamentin e Financë Bankë Kontabilitet, dhe specifikisht për këtë program studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja web e UMSH, GVJ konkludon se

<p>mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</i>  <i>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_TRF.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar që pranohen në këtë program studimi kandidatët të cilët kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të IAL-së ku aplikojnë.</p> <p>Kriteret e aplikimit, dhe udhëzimet për procedurën e aplikimit shpallen në faqen web të UMSH.</p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_TRF.pdf</i>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit">https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se kriteret e aplikimit, dhe udhëzimet për procedurën e aplikimit bëhen publike në faqen web të UMSH, dhe njëkohësisht në rrjetet sociale të institucionit. Sekretaria mësimore, zyra e këshillimit të karrierës dhe koordinatori i programit asistojnë në proces nëpërmjet informimit të drejtpërdrejtë të kandidatëve të interesuar në mjediset e institucionit.</p> <p><i>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_TRF.pdf</i>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet">https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, si dhe konsultimit të faqes web të UMSH, GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, procedurave të transferimit, njohjes së plotë ose të pjeshme të studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme nga publiku:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në sekretarinë mësimore të UMSH;</li> <li>- Afishimit të informacionit në stenda në ambientet e UMSH</li> <li>- Nëpërmjet kontakteve më koordinatorin e programit;</li> <li>- Faqen web të USMSH</li> </ul> <p><i>Referenca: www.umsh.edu.al; vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat</p>	<p>Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me UMSH, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to, realizohet nëpërmjet faqes web të UMSH. Gjithashtu në faqen web jepet informacion i plotë mbi fituesit.</p>



e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Kriteret e pranimit janë të paraqitura në rregulloren e programit të studimit. Konkretisht në këtë rregullore, specifikohen kriteret si më poshtë:

1. Masterin e Shkencave në Financë Bankë, me profile, mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike e private) dhe nga vende të tjera shqipfolëse të cilët zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.

2. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

3. Në Masterin e Shkencave në Financë Bankë me profile mund të pranohen pa plotësim kreditesh studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkenca ekonomike pranë UMSH, në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave.

4. Në Masterin e Shkencave në Financë Bankë me profile mund të pranohen pa plotësim kreditesh studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkenca ekonomike apo profile të ngjashme në Universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave.

5. Në Masterin e Shkencave në Financë Bankë me profile mund të pranohen me plotësim kreditesh studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në fusha të tjera apo profile të ngjashme në Universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave. Pranimi i këtyre studentëve në Msc FB do t'i nënshtrohet fillimisht ekuivalentimit të diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati dhe miratuar nga Rektori. Në këtë procedurë përfshihet edhe përcaktimi i debiteve formuese që studenti duhet të plotësojë para hyrjes në programin e studimit.

Mbi bazën e informacioneve RVB dhe vizitës në institucion, RVJ konstaton se kriteret rishikohen në mënyrë periodike.

*Bazuar në tabelat përmbledhëse të RVB evidentohet se gjate 3 viteve të fundit akademik nota mesatare e studenteve të regjistruar në programin bachelor që ata kane përfunduar është në kufijtë 6.7 deri 7.5. Institucioni nuk ka kufi të poshtëm të notes mesatare të pranimit të studenteve, vendosja e të cilës do të rriste nivelin e cilësisë se studenteve të regjistruar për here të pare.*

**Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit\_ BTF\_TRF.pdf**


	<a href="https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi">https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi</a>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>GVJ konstanton se në Evidencën 20- Rregullore për studentët me aftësi ndryshe parashikohet trajtimi i studentëve me aftësi ndryshe. Pranimi i studentëve me aftësi ndryshe ndjek procedurat sipas legjislacionit në fuqi, dhe rregulloreve të UMSH.</p> <p>Mbi bazën e informacionit të paraqitur në RVB, UMSH, alokon bursa për kategori sociale të veçanta për studentë nga shtresa dhe komunitete të marginalizuara siç janë ata romë dhe ballkano-egjiptianë, si dhe studentë me aftësi ndryshe.</p> <p><b>Evidenca 20. Rregullore për studentet me aftësi ndryshe.pdf</b></p>			
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	NA			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Referuar RVB, UMSH sipas rasteve specifike dhe sipas kërkesave të studentëve në formularin e tyre të aplikimit në UMSH, alokon bursa për kategori sociale të veçanta për studentë nga shtresa dhe komunitete të marginalizuara siç janë ata romë dhe ballkano-egjiptianë, si dhe studentë me aftësi ndryshe. Kategoritë e bursave që ofrohen nga UMSH janë: a) bursat sociale; b) bursat e ekselencës; c) bursat e talentit dhe sportit; d) bursat mbështetëse.</p> <p>Informacioni mbi bursat gjendet i përditësuar në faqen web të UMSH.</p> <p><b>Referenca:</b> <a href="https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat">https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat</a></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstanton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</li> <li>- Institucioni publikon përpara fillimit të çdo viti akademik, kriteret dhe procedurat e pranimit në programin e studimit duke garantuar akses në informacion dhe barazi në procesin e pranimit të aplikimeve dhe të përzgjedhjes për të gjithë kandidatët.</li> </ul> <p>Institucioni ka politika që trajtojnë aplikimet nga personat me aftësi të veçanta, grupeve të marginalizuara, si dhe shtetasit shqiptarë që vijnë nga trojet.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UMSH, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve dhe moduleve të mëparëshme në rast transferimi studimesh. Këto kritere dhe procedura janë pjesë e Rregullores së UMSH, rregullore së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe veçanërisht të Rregullores së programit të studimit. Informacioni është publikuar edhe në faqen web të UMSH.</p> <p>Njëkohësisht, janë përgatitur manual dhe udhëzues të veçantë për informimin e studentëve mbi këto aspekte. Informacioni është i paraqitur edhe në faqen web të UMSH.</p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</i>  <i>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_ TRF.pdf</i>  <i>Evidenca 22. Udhëzuesi i Studentit.pdf</i>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet">https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit dhe rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike, GVJ konstatoi se studentit i ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda institucionit ashtu edhe nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, si dhe në rregulloren e programit të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Udhëzuesi i studentit po ashtu përmban informacion të plotë mbi procesin. Informacioni mbi procedurën e transferimit shfaqet edhe në një rubrikë të veçantë në faqen web të UMSH.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore u kërkua dosja e një studenti të transferuar të zgjedhur nga GVJ në mënyrë rastësore dhe dosja rezultoi e plotë, si dhe ishin ndërmarrë të gjithë hapat e përmendur më sipër gjatë procedurës së transferimit.</p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</i>  <i>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_ TRF.pdf</i></p>

	<p><b>Evidenca 22. Udhëzuesi i Studentit.pdf</b>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet">https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit dhe Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike. Në orën e parë të fillimit të procesit mësimor për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu për syllabusin e lëndës, detyrimeve për t'u përmbushur si edhe mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 100 pikësh, i cili konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar. Bazuar në rregulloret e mësipërme, si dhe nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstatoi se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet në mënyrë të ngjashme për të gjitha lëndët e kurrikulës së këtij programi duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 100 pikë). Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të procesit mësimor, në përputhje me aktet rregullatore dhe të pasqyruara në programet e lëndëve. GVJ pas shqyrtimit të syllabuseve konstatoi se në to' paraqitet i plotë informacioni mbi kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Kuadri rregullator i brendshëm në nivel institucional, njësie kryesore , njësi baze dhe vetë rregulloren e këtij programi përcaktojnë se nëse studenti nuk frekuenton 25% të lëndës, ai klasifikohet që nuk ka frekuentuar lëndën, vlerësohet me notën 4 dhe duhet të frekuentojë lëndën vitin pasardhës.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike</b>  <b>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</b>  <b>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_ TRF.pdf</b>  <b>Evidenca 14.2.1 Syllabuse 2023-2024 vitit pare BTF, TRF.pdf</b>  <b>Evidenca 14.2.2 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte BTF.pdf</b>  <b>Evidenca 14.2.3 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte TRF.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike, dhe rregullores së programit të studimit dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit për këtë program studimi.</p> <p>Procedura e mbrojtjes së diplomës, për studentët e programit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" është vetëm me mbrojtje tezë diplome.</p> <p>Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga njësi baze dhe aprovohen nga drejtuesi i njësisë kryesore. Tema e diplomës duhet të</p>



	<p>përkojë me fushat e kërkimit të departamentit. GVJ konstatoi shpërndarjen e pedagogëve mbi bazën e fushës së ekspertizës së tyre.</p> <p>Punimi/ provimi i diplomës vlerësohen me notë, nga komisioni i ngritur nga njësia bazë. Referuar takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët ishin të mirëinformuar për mënyrën dhe procedurat e diplomimit, gjatë viteve të studimeve. Informacioni mbi procesin e diplomimit është i publikuar edhe në faqen web të UMSH.</p> <p><b>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike</b>  <b>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</b>  <b>Evidenca 9. Rregullore Programi i studimit_ BTF_ TRF.pdf</b>  <b>Evidenca 11. Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese DFBK 2022-2023.pdf</b>  <b>Evidenca 21. Udhëzues për përgatitjen e diplomes.pdf</b>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit">https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe në faqen web të UMSH, GVJ konstatoi se Institucioni realizon aktivitete si: fushatë informimi, afishim të informacionit në mjediset e UMSH, komunikim në rrjetet sociale, takime informale me studentët, si edhe publikim në faqen web të UMSH për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi këtë dhe programe të tjera studimi që ofron Institucioni. Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës është aktive në këtë drejtim. Gjithashtu Institucioni ka prodhuar materiale në formatin e broshurës për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p> <p><b>Evidenca 36. Broshura e programeve Master.pdf</b>  <b>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</b>  <b>Referenca të tjera: <a href="http://www.umsh.edu.al">www.umsh.edu.al</a></b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.</li> <li>- Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, praktikës profesionale, si dhe përmblyljes së tyre me tezë diplome.</li> <li>- Institucioni realizon një numër aktivitetsesh dhe ofron informacion duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Referuar RVB, vizitës në institucion, si dhe faqes web të UMSH, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" informohen në fillim të studimeve nga pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierësm, si dhe sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Informacion ofrohet edhe në faqen web të UMSH si edhe në rrjetet sociale, që administrohen nga Institucioni.  <i>Evidenca 36. Broshura e programeve Master.pdf</i> <i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i> <i>Referenca: <a href="https://umsh.edu.al">https://umsh.edu.al</a>; vizita në institucion</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e këtij program studimi marrin informacion më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit, gjatë prezantimit të orës së parë të mësimit nga pedagogët e lëndës. Informacion të detajuar studentët mund të gjejnë edhe në: sekretarinë mësimore, faqen web të UMSH, afishimeve në ambientet e Institucioni, rrjeteve sociale, si edhe komunikimit me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në klasat virtuale të krijuara prej tyre. Njëkohësisht informacioni paraqitet i plotë në përmbajtje të syllabuseve të shqyrtuara nga GVJ.  <i>Evidenca 14.2.1 Syllabuse 2023-2024 vitit pare BTF, TRF.pdf</i> <i>Evidenca 14.2.2 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte BTF.pdf</i> <i>Evidenca 14.2.3 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte TRF.pdf</i> <i>Evidenca 36. Broshura e programeve Master.pdf</i> <i>Referenca: <a href="https://umsh.edu.al">https://umsh.edu.al</a></i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se kjo strukturë kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe mundësitë për internship. Kjo zyrë ka në fokus ofrimin e këshillimit për studentët për t'i përgatitur për të aplikuar për punësim, si dhe organizon evente në funksion të punësimit, si leksione të hapura, takime më rrjetin Alumni, etj. Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me institucione të ndryshme i shërbenin po ashtu këtij qëllimi.  Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht gjatë takimit me studentë, doli në pah se informacioni për punësim u ofrohej edhe nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi, dhe nga Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet, përgjegjës për këtë program studimi.  <i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i>

	<p><i>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 46. Takim me Bordin e tregut të punes.pdf</i>  <a href="https://umsh.edu.al">https://umsh.edu.al</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se, pedagogët e departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitet, në javën e parë të fillimit të studimeve, pedagogët e tjerë të angazhuar në këtë program studimi, sekretaria mësimore, biblioteka, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja web e UMSH si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor. Informacioni paraqitet edhe në format broshure, si dhe gjendet i përditësuar në kalendarin akademik të institucionit.</p> <p><i>Evidenca 30. Kalendari akademik 2022-2023.pdf</i>  <i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i>  <i>Evidenca 36. Broshura e programeve Master.pdf</i>  <a href="https://umsh.edu.al">https://umsh.edu.al</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet faqes Web të UMSH-se dhe hapësirës së dedikuar në portalin studentor, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, të konsultojnë vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe universiteti.</p> <p><i>Referenca: <a href="https://umsh.edu.al">https://umsh.edu.al</a></i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët informohen në fillim të vitit akademik, si dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe elementët ndihmës në funksion të tij.</li> <li>- Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, si dhe pedagogët e Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitet, ofrojnë informacion për mundësitë e punësimit të studentëve.</li> </ul> <p>Studentët janë të përditësuar dhe kanë si akses fizik ashtu edhe online, në informacionin në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën, logjistikën dhe elementë të tjerë mbështetës të tij.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.4**

<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>										
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>									
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Mbi bazën e dokumentave shoqëruese dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Sekretaria Mësimore në UMSH është njësi që kujdeset për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve e të diplomuarve, në të gjithë programet e studimit të ofruar nga institucioni.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <i>Evidenca 16. Përmbledhëse e tabelave të programit të studimit MSCFB me profile.pdf</i>  <i>tabela FB.pdf</i></p>									
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i lëshimit të diplomave) janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p>Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> <th>2023-2024</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>40 (Profili Teknologjitë e reja financiare)</td> <td>50 (Profili Teknologjitë e reja financiare)</td> <td>50 (Profili Teknologjitë e reja financiare)</td> </tr> <tr> <td>97 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)</td> <td>80 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)</td> <td>45 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton se gjate dy viteve të fundit akademike në këtë program janë transferuar nga universitete të tjera 15 studentë .</p> <p>Numri total i të diplomuarve në këtë program është 85 studentë nga të cilët janë të punësuar në përputhje të diplomës 71 studentë.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <i>Evidenca 16. Përmbledhëse e tabelave të programit të studimit MSCFB me profile.pdf, tabela 21</i></p>	2021-2022	2022-2023	2023-2024	40 (Profili Teknologjitë e reja financiare)	50 (Profili Teknologjitë e reja financiare)	50 (Profili Teknologjitë e reja financiare)	97 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)	80 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)	45 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)
2021-2022	2022-2023	2023-2024								
40 (Profili Teknologjitë e reja financiare)	50 (Profili Teknologjitë e reja financiare)	50 (Profili Teknologjitë e reja financiare)								
97 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)	80 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)	45 (Profili Banka dhe Tregje Financiare)								

<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UMSH. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër (versioni hard copy) dhe në sistemin e menaxhimit informatik ruhet në versionin elektronik (soft copy). Të dy mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <i>Evidenca 35. Manual i përdorimit të platformave elektronike.pdf</i>  <a href="http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar">http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB, Statutit të UMSH, dhe Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike, RVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për secilin program studimi. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit gjatë mbledhjeve të departamentit.</p> <p><i>Gjithashtu nuk paraqitet një analizë e ecurisë së programit, shoqëruar me rekomandime dhe masa në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Evidenca 16. Përmbledhëse e tabelave të programit të studimit MSCFB me profile.pdf</i>  <i>Evidenca 12. Procesverbal mbledhje DFBK.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UMSH mban dhe disponon statistika mbi numrin studentëve të regjistruar sipas programeve dhe cikleve të studimit.</li> <li>- Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</li> </ul>



	<p>- Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.</p> <p><i>GVJ eidenton qe nuk paraqitet një analizë e ecurisë së programit, shoqëruar me rekomandime dhe masa në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se Studentët janë pjesë e strukturave vendimmarrëse ne institucion. GVJ eidentoi qe studentët kane Këshillit Studentor si organ i bazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi (Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Statutit të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë", neni 81, pika c ).</p> <p>Funksionimi i Këshillit studentore rregullohet nga Statuti dhe Akti i themelimit si dhe nga Rregullorja e brendshme e tij,</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti i UMSH</i>  <i>Evidenca 4. Rregullore e organizimit UMSH</i>  <i>Evidenca 37. Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se aktualisht UMSH përdor sistemin e pyetësorëve dhe procedurave me fokus grupe me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJSBCZHK dhe përfundon me hartimin e rezultateve të vlerësimit të cilat u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe përgjegjësit të njësisë bazë dhe kryesore për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet, përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe koordinatorit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</i></p>



	<p><i>Evidenca 34. Procedurat e punës me fokus grupet.pdf</i>  <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe veçanërisht Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet koordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBCZHK -së përpunon të dhënat e pyetësorëve dhe fokus grupeve. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagogut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikat e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Dokumenta shitesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 34. Procedurat e punës me fokus grupet.pdf</i>  <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i>  <i>Evidenca 12. Procesverbal mbledhje DFBK.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>RVJ konstaton se në statutin e UMSH dhe në rregulloret e përkatëse të institucionit dhe të programit të studimit, është e sanksionuar dhënia e të drejtës së studentëve për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e provimit nga ana e njësisë bazë dhe njësisë kryesore si dhe pedagogut përgjegjës.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore e Departamentit të Ekonomisë</i>  <i>Evidenca 9. Rregullore e programit MSCFB me profile</i>  <i>Evidenca nr.1. Statuti i UMSH</i>  <i>Evidenca 40. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregulloret e institucionit u mundësojnë studentëve përfaqësimin në organet e UMSH.</li> <li>- Studentët përfshihen në këshillim, sugjerim për rishikim dhe përmirësim të programit të studimit kryesisht bazuar në përpunimin e të dhënave të pyetësorëve nga NJSBCZHK.</li> </ul> <p>Studentët kanë të drejtën e ankimit për shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin në provim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.6**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (0) 222-13423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

71

<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në Statutin dhe rregulloret e UMSH, si dhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore; koordinatori i programit të studimit; si dhe Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës.</p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</i>  <i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet, që është edhe njësi bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësisë të sipërpërmendura, por edhe stafit të saj akademik. Koordinator i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Njëkohësisht, Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës është njësi përgjegjëse për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</i>  <i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se shërbimi i këshillimit të karrierës për studentët e UMSH ofrohet nga Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës. Specialistët e Sektorit të Këshillimit të Karrierës, këshillojnë studentët për të gjitha hallkat në përgatitjen për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si: trajnime me fokus përgatitjen për intervistë pune, leksione të hapur (me të ftuar) me përfaqësues nga bota akademike dhe e biznesit, përdorimin e faqes web të UMSH, etj, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes aktive, të promovimit të studentëve, si dhe të rritjen e mundësive të punësimit të tyre. Programi i studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare", ka pjesë të kurrikulës praktikën profesionale, që zhvillohet për 3 muaj, gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë akademik. Gjatë vizitës në Institucion, studentët nxorën në pah, se krahas përfaqësuesve të zyrës së Karrierës, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, u ofron shpesh informacion për mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale dhe për punësim.</p> <p><i>Evidenca 38. Rregullore e ZKSK.pdf</i></p>


<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ evidenton konsultimin me rrjetin ALUMNI nëpërmjet takimeve të prezantuara në faqen web të UMSH, por nuk evidenton formalizimin e procesit të përfshirjes së rrjetit ALUMNI në procedurat e Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës.</p> <p><i>GVJ rekomandon formalizimin e përfshirjes së rrjetit ALUMNI në politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><b>Reference:</b> <a href="http://www.umsh.edu.al">www.umsh.edu.al</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni ka njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore; koordinatori i programit të studimit; si dhe Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës.</li> <li>- Njësia bazë që mbulon këtë program studimi është gjithashtu përgjegjëse për informim dhe shërbim ndaj studentëve.</li> <li>- Specialistët e Zyrës së Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës dhe Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet u ofrojnë studentëve informacion dhe këshillim për procesin mësimor, praktika profesionale, si dhe orientim në tregun e punës.</li> <li>- GVJ evidenton konsultimin me rrjetin ALUMNI nëpërmjet takimeve të prezantuara në faqen web të UMSH, por nuk evidenton formalizimin e procesit të përfshirjes së rrjetit ALUMNI në procedurat e Zyra e Këshillimit të Studenteve dhe Karrierës.</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon formalizimin e përfshirjes së rrjetit ALUMNI në politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentave shoqëruese dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni ka në fokus të politikave dhe objektivave të tij zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit. Analiza e syllabuseve tregon se në lëndë të veçanta janë integruar elemente inovative në mësimdhënie, të lidhur me format e kontrollit të dijeve, formatet e ligjërimit, etj. Gjithsesi, nga evidencat e paraqitura nuk japin informacion specifik mbi strategjinë për mësimdhënie dhe mësimnxënie inovative.</p> <p><i>GVJ rekomandon përpilimin e strategjive të përqendruara në futjen e elementëve novatorë të mësimdhënie, sidomos duke veçuar orientimin e profilit të dytë të programit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profil "Teknologjitë e Reja Financiare".</i></p> <p><b>Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH.pdf</b>  <b>Evidenca 5. Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit MSCFB me profile.pdf</b>  <b>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</b>  <b>Evidenca 14.2.1 Syllabuse 2023-2024 vitit pare BTF, TRF.pdf</b>  <b>Evidenca 14.2.2 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte BTF.pdf</b>  <b>Evidenca 14.2.3 Syllabuse 2023-2024 viti i dyte TRF.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBCZHK pranë UMSH mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërie në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standardet e cilësisë të përcaktuar nga UMSH, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. NJSBCZHK bashkëpunon në veprimtarinë e saj në drejtim të sigurimit të cilësisë me departamentet, dekanatin dhe rektoratin.</p> <p>Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Institucioni bën monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, kryesisht nëpërmjet përdorimit të mekanizmave të tilla si anketa dhe pyetësorë.</p> <p>Gjithashtu stafi akademik plotëson një Formular vetëvlerësimi për performancën e stafit akademik, në fund të çdo viti akademik, si dhe realizohet një analizë e ecurisë së punës vjetore të njësisë kryesore.</p> <p><b>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</b>  <b>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në NJSBCZHK të përbërë nga 9 anëtarë, ka edhe përfaqësues prej studentëve. Gjithashtu edhe GVB gjithmonë ka në përbërjen e tij një student nga programi që akreditohet.</p>




<p>mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Ndërkohë mbështetur në rregulloren e UMSH studentët përfshihen rregullisht në vlerësimin e stafit akademik dhe programit të studimit nëpërmjet plotësimit të formularëve që shpërndan NJSBCZHK, një për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik dhe tjetri për përmbajtjen e lëndës, duke dhënë vlerësimin dhe komentet për përmirësimin e këtij program studimi, si në funksion të mësimdhënies, ashtu edhe të kurrikulës. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Institucionin, njësinë kryesore dhe veçanërisht me njësinë bazë.</p> <p>Së fundi, konstatohet se studentët bëhen pjesë e vlerësimit periodik të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet aktiviteteve të posaçme, si fokus grupet, që kanë qëllim evidentimin e ecurisë së vitit akademik përkatës.</p> <p><i>Evidenca 37. Rregullore e funksionimit të këshillit Studentor.pdf</i>  <i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 34. Procedurat e punës me fokus grupet.pdf</i>  <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i>  <b>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në UMSH, GVJ konkludoi se NJSBCZHK si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ia paraqet rezultatet e përpunimit të pyetësorëve Njësisë Kryesore, Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Rektoratit.</li> <li>- Rezultatet e anketimeve i vihen në vëmendje dekanit, i cili në rast problematikash zhvillon diskutime me pedagogun përkatës për zgjidhjen e tyre.</li> <li>- Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave harton një raport vjetor të punës së saj, i cili i paraqitet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe një kopje e tij përcillet për dijeni dhe informim në Dekanat. Ky raport dërgohet për miratim në Senatit Akademik të UMSH. Të gjitha raportet përfundimtare të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave protokollohen, arshivohen, dhe publikohen në përputhje me aktet juridike të institucionit.</li> </ul> <p>GVJ konstaton se raportet vjetore të hartuara nga NJSBCZHK që nga viti akademik 2018-2019 janë bërë publike në faqen web të UMSH, në rubrikën: <a href="https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise">https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise</a></p> <p><b>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të</p>	<p>Referuar vizitës në Institucion, në takimin me stafin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi gatishmërinë e Institucionit për</p>



<p>vlerësimin dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor, ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore). Gjithashtu, si pjesë e praktikës së punës për sigurimin e cilësisë, rezultatet e anketimeve të zhvilluara nga NJSBCZHK i vihen në vëmendje dekanit, i cili në rast problematikash zhvillon diskutime me pedagogun përkatës për zgjidhjen e tyre.</p> <p><b>Evidenca 28. Plani i Trajnimeve 2022-2023.pdf</b> <b>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të Universitetit.</li> <li>- Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, veçanërisht NJSBCZHK dhe Departamenti i Financë, Bankë Kontabilitet, vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik, raportojnë në instancat përkatëse sipas rregullores së UMSH, gjë që reflektohet në vendimmarrjet e mëtejshme në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</li> <li>- Studentët përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vlerësimin të cilësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, pjesëmarrjes në komisionet e përhershme, si edhe këshillit studentor.</li> <li>- Institucioni është i angazhuar në nxitjen e personelit akademik në funksion të mësimdhënies dhe kualifikimit shkencor.</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon përpilimin e strategjive të përqendruara në futjen e elementëve novatorë të mësimdhënies, sidomos duke veçuar orientimin e profilit të dytë të programit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare"</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se statuti i UMSH (Kreu XI, neni 53 dhe 84) dhe rregullorja e UMSH (Kreu IV, neni 28) përcakton që Institucioni harton politika dhe</p>

<p>Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>procedura në funksion të sigurimit të cilësisë. Në institucion është krijuar dhe është aktive NJSBCZHK, njësia që përcakton procedurat dhe metodat për sigurimin e cilësisë në institucion.</p> <p><i>Evidenca 1. Statuti UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në UMSH është ngritur dhe është aktive NJSBCZHK, njësi ndihmëse në funksion të zbatimit të politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në varësi të Rektorit. NJSBCZHK përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët janë personel akademik me kohë të plotë dhe/ose personel ndihmës akademik dhe/ose ekspertë të fushave të ndryshme dhe një anëtar është student i një prej degëve të studimit të UMSH. Anëtarët e NJSBCZHK kanë mandat 3 vjeçar. Drejtimi i punës së kësaj njësie bëhet nga kryetari i NJSBCZHK.</p> <p>UMSH ka hartuar planin për zhvillimin strategjik të institucionit ku evidentohet qartësisht që Universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit. Fokusi i Institucionit për t'i bërë këto struktura sa më efektive doli në pah edhe gjatë takimeve të GVJ-së gjatë vizitës në UMSH.</p> <p><i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UMSH ka realizuar dy procese vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimit Institucional pranë ASCAL. Vlerësimi i fundit është bere me vendim të Bordit të Akreditimit nr.62 date 18.12.2020 , ku UMSH u akreditua për 6 vite akademike.</p> <p>Aktualisht UMSH është duke realizuar procesin e vlerësimit të jashtëm për programet të studimit, duke përfshirë edhe programin e studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare".</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare", është duke u vlerësuar për herë të parë nga ASCAL.</p> <p><u><i>Evidence nga arkiva: Vendim I Bordit të Akreditimit</i></u></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në</p>	<p>GVJ referuar dokumentave të dorëzuara dhe vizitës në Institucion, konkludon që NJSBCZHK përpunon të dhënat duke llogaritur tregues</p>

<p>mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në veçanti njësia bazë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.</p> <p><b>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</b>  <b>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatorë.</li> <li>- UMSH ka hartuar planin për zhvillimin strategjik të institucionit ku evidentohet përkushtimi ndaj cilësisë.</li> </ul> <p>NJSBCZHK përgatit raporte me tregues sasior dhe cilësor, dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të përmirësimit të cilësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se në UMSH aktiviteti i NJSBCZHK -së ka një sistem raportimi vjetor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</p> <p>Aktualisht pyetësori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron UMSH. Vlerësimet e NJSBCZHK raportohen në strukturat drejtuese pranë njësive kryesore, të cilat marrin masa në bashkëpunim me pedagogun për prblematikat e evidentuara.</p> <p>Gjithsesi, duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur, GVJ nuk evidenton ndonjë raport/analizë të njësive bazë të hartuar në kuadër të rezultateve të procesit të vlerësimit të cilësisë për programin e studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon përdorimin e rezultateve të procesit të vlerësimit për hartimin e raporteve periodike të njësive kryesore, në funksion të</i></p>

<p>njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>përmirësimit të cilësisë dhe rishikimit të objektivave strategjike të lidhura me programin e studimit.</i></p> <p><b>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</b> <b>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoni se problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, pyetësorët për personelin akademik dhe joakademik si dhe formularët e vetëvlerësimit u bëhen të njohura Dekanit të FSHE i cili shqyrton problematikat dhe i adreson në bashkëpunim me pedagogun.</p> <p>Rezultatet e raporteve janë pjesë e diskutimeve gjatë mbledhjeve të departamenteve.</p> <p>Raportet periodike të hartuar nga NJSBCZHK bëhen publike në faqen web të UMSH.</p> <p>Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacioni të paraqitur GVJ nuk evidenton materiale në format raporti të njëjësive bazë apo njësisë kryesore.</p> <p><i>GVJ rekomandon përpunimin e informacionit sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesin mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe hartimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve për të ardhmen.</i></p> <p><b>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</b> <b>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</b> <b>Evidenca 12. Procesverbal mbledhje DFBK.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që mbulon këtë program studimi, GVJ konstatoi se përdoren disa procedura periodike të drejtpërdrejta për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti.</p> <p>Për nevoja të monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, NJSBCZHK, njësite bazë dhe kryesore përdorin metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i rezultateve të mësimdhënies (kalueshmëria dhe nota mesatare për çdo lëndë dhe grup mësimor);</li> <li>• Diskutime të problematikave të hasura gjatë procesit të mësimdhënies në mbledhjet e Departamentit;</li> <li>• Vëzhgime në auditor gjatë realizimit të provimeve;</li> <li>• Monitorime periodike të zhvillimit të procesit mësimor në auditor;</li> <li>• Nota mesatare në hyrje dhe dalje;</li> <li>• Rishikime të syllabuseve</li> <li>• Raportet e vetëvlerësimit</li> </ul>



	<p>Për më tepër, në nivel departamenti, stafi akademik vazhdimisht gjatë zhvillimi të aktivitetit mësimor nxit studentët të japin opinionet dhe sugjerimet e tyre për lëndët dhe programin në tërësi, duke mundësuar vlerësim dhe përmirësim të vazhdueshëm të tij.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</i>  <i>tabela FB.pdf</i>  <i>Evidenca 32. Plani i monitorimit DFBK.pdf</i>  <i>Evidenca 12. Procesverbal mbledhje DFBK.pdf</i>  <i>Evidenca 41. Raport i vetëvlerësimit individual.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Në takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që mbulon këtë program studimi, GVJ konstatoi se përdoren disa procedura periodike të tërthorta për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti. Ato përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• anketime dhe pyetësorë,</li> <li>• procedura me fokus grupe,</li> <li>• takime me studentë</li> </ul> <p>Në vazhdim, mbi bazën e procedurave të realizuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- NJSBCZHK përpunon rezultatet e nxjerra;</li> <li>- Rezultatet i bëhen të njohura drejtuesit të njësisë bazë dhe kryesore, dhe në mënyrë konfidenciale pedagogëve për të evidentuar dhe adresuar problematika të ndryshme që kanë dalë nga analiza e rezultateve të procedurave të NJSBCZHK.</li> <li>- NJSBCZHK harton raportin vjetor që bëhet publik në faqen web të UMSH.</li> </ul> <p>GVJ evidenton konsultimin me rrjetin ALUMNI nëpërmjet takimeve të prezantuara në faqen web të UMSH, por nuk evidenton formalizimin e procesit të përfshirjes së rrjetit ALUMNI në procedurat e sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>GVJ rekomandon përdorimin dhe evidentimin e rezultateve të metodave të drejtpërdrejta të sigurimit të cilësisë në analizat e punës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GJV rekomandon formalizimin e përfshirjes së rrjetit ALUMNI në politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Dokumenta shtesë: Raport vlerësimi NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 34. Procedurat e punës me fokus grupet.pdf</i>  <i>Evidenca 31. Formular i Vlerësimit të pedagogut nga Autoriteti Drejtues.pdf</i>  <i>Evidenca 32. Plani i monitorimit DFBK.pdf</i></p>



	<i>Evidenca 39. Aneksi A Vlerësimi i performances .pdf</i> <i>Evidenca 25. Formulari i Vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UMSH ka një sistem raportimi që konsiston në llogaritje treguesish sasior dhe cilësor, bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</li> <li>- Rezultatet e procesit bëhen të njohura në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore, por nuk evidentohen analiza vjetore të punës mësimore dhe kërkimore bazuar në përpunimin e pyetësorëve, formularët e vetëvlerësimit, duke nxjerrë në pah arritjet dhe rekomandimet për të ardhmen. GVJ rekomandon hartimin e analizave vjetore në nivel njësie bazë dhe kryesore mbi bazën e rezultateve të metodave të drejtpërdrejta dhe tërthorta të sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</li> </ul> <p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të cilësisë përdor një sërë metodash të tërthorta, megjithatë GVJ sugjeron përfshirjen më aktive të rrjetit ALUMNI në funksion të përmirësimit të kurrikulës së këtij program studimi.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë konform legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Struktura kryesore në këtë proces është NJSBCZHK, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe veçanërisht me njësinë bazë dhe kryesore, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërie në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së UMSH, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Referuar rregullores së UMSH në këto struktura përfshihen personel akademik efektiv, personel ndihmës akademik, studentë si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunorë në projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Studentët janë të

	<p>përfaqësuar në Senatin e UMSH, në NJSBCZHK, në Bord Administrimi, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm MSC FB me Profile.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, në statutin dhe rregulloren e UMSH, janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.</p> <p>Në rregulloret e UMSH, NJSBCZHK, Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe të Departamentit të Financë, Bankë, Kontabilitet janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse në funksion të sigurimit të cilësisë. Ndërkohë në çdo grup pune të ngritur në kuadër të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen detyrat për çdo anëtar të grupit të punës. Detyrat janë të përcaktuara qartë edhe për studentët kur këta janë të përfaqësuar në këto grupe vlerësimi. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që studentit të angazhuar në GVB për këtë program studimi, i ishin përcaktuar detyrat përkatëse që do të kishte në funksion të përgatitjes së RVB.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike</i>  <i>Evidenca 8. Rregullore_ Departamenti FBK_ SHE.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UMSH ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBCZHK shërben si njësi ndihmëse në funksion të zbatimit të politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe është në varësi të Rektorit. NJSBCZHK përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët janë personel akademik me kohë të plotë dhe/ose personel ndihmës akademik dhe/ose ekspertë të fushave të ndryshme dhe një anëtar është student i një prej degëve të studimit të UMSH. Anëtarët e NJSBCZHK kanë mandat 3 vjeçar. Drejtimi i punës së kësaj njësie bëhet nga kryetari i NJSBCZHK.</p> <p>Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë edhe Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike, si njësi bazë dhe kryesore që ofrojnë këtë program studimi. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit janë personeli akademik i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë. Ndërkohë pjesë e këtij vlerësimi janë edhe personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, si pjesë aktive e proceseve dhe procedurave të sigurimit të cilësisë. Në vlerësimin e jashtëm të këtij program studimi janë angazhuar në GVB pesë anëtarë: katër personel akademik dhe një student.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 2. Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i>  <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm MSC FB me Profile.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të</p>	<p>Referuar RVB si dhe informacionit të vjelë gjatë takimit me stafin drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, personelin akademik të angazhuar në</p>


<p>brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>këtë program studimi GVJ konstaton se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm bëhet me vendim departamenti, me propozim nga anëtarët e këtij departamenti. Për sa i përket studentëve ata vijnë si përfaqësues të përzgjedhur nga vetë studentët apo këshilli studentor duke shmangur kështu çdo element diskriminimi apo pabarazie.</p> <p><b>Vizita në Institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në funksion të rritjes së cilësisë janë lidhur një sërë marrëveshesh në nivel Institucioni dhe në nivel njësie kryesore. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, mundësojnë organizimin e aktiviteteve të ndryshme si trajnime dhe workshop-e, leksione të hapura, organizimin e panairit të punës; etj. Gjithashtu mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentë, si dhe shpesh luajnë rol aktiv në punësimin e studentëve. Vlerësohet krijimi i Bordit të tregut të punës, në mbështetje të lidhjes së institucionit me bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që Departamenti i Financë, Bankë, dhe Kontabilitet, duhet të realizojë aktivitete me Institucione publike dhe private me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, të tipit "Tavolinë e rrumbullakët", "Workshop", me qëllim që të marrë feedback-un e tyre në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare" dhe bërjen e tij një program më tërheqës në treg, në kushtet e rënies së numrit të studentëve.</i></p> <p>GVJ evidenton konsultimin me rrjetin ALUMNI nëpërmjet takimeve të prezantuara në faqen web të UMSH, por nuk evidenton formalizimin e procesit të përfshirjes së rrjetit ALUMNI në procedurat e sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të forcohet komunikimi dhe bashkëpunimi me rrjetin ALUMNI, veçanërisht në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit- përmirësimit të kurrikulës dhe të procesit mësimor.</i></p> <p><b>Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH.pdf</b>  <b>Evidenca 46. Takim me Bordin e tregut të punës.pdf;</b>  <b>Evidenca 17. Leksione të hapura DFBK.pdf</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, të cilat kanë</li> </ul>

	<p>në përbërje të tyre personel akademik, ndihmës akademik dhe studentë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përzgjedhja e anëtarëve të strukturave të vlerësimit të cilësisë bëhet në respekt të integritetit akademik, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë.</li> <li>- Anëtarët e njësive të sigurimit të cilësisë kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.</li> </ul> <p><i>GVJ sugjeron që pjesë aktive e procesit të vlerësimit të cilësisë të bëhen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm të Institucionit, veçanërisht përfaqësues të rrjetit ALUMNI dhe përfaqësues të institucioneve publike dhe private me të cilat Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe të marrë gjatë vizitës në UMSH, GVJ konstaton se raportet e NJSBCZHK publikohen periodikisht në faqen Web të tij. Informacionet e lidhura me programin e studimit janë po ashtu të publikuara në web dhe në broshurën e UMSH.</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve dhe instrumenteve të tjerë që përdor NJSBCZHK në kuadër të sigurimit të cilësisë i bëhen të njohura njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë konfidenciale edhe pedagogëve përkatës. Studentët informohen përmes njësisë bazë për problematikat që mund të shfaqen në lidhje me cilësinë.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i> <i>ëëë.umsh.edu.al</i> <i>Evidenca 36. Broshura e programeve Master.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në UMSH, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. GVJ konsultoi faqen web të Institucionit dhe konstatoi se raportet e prodhuara nga NJSBCZHK, respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Rezultatet që dalin nga përpunimi i pyetësorëve nga NJSBCZHK ju dërgohen individualisht secilit personel akademik, si dhe përgjegjësit të</p>



	<p>njesisë bazë dhe kryesore. Problematikat adresohen në bashkëpunim me pedagogët përkatës.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <i>Evidenca 7. Rregullore Fakulteti i Shkencave Ekonomike (2).pdf</i>  <a href="http://www.umsh.edu.al">www.umsh.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë dhe kryesore informohet nga NJSBCZHK mbi rezultatet e analizës së pyetësorëve dhe mjeteve të tjera të tërthorta të përdorura për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Mbi bazën e rezultateve, adresohen problematika të ndryshme në bashkëpunim me pedagogun.</p> <p>Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në faqen web të UMSH, GVJ evidenton publikimin e raporteve vjetore të UMSH që analizojnë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore, ato të kërkimit shkencor dhe marrëdhëniet me studentët. Vlerësimi realizohet në bashkëpunim me Njësitë bazë dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel të Njesisë kryesore.</p> <p><i>GVJ nga informacioni i dokumentacionit shoqërues nuk konstatoi analiza formale të punës së njesisë bazë dhe kryesore apo ndonjë plan masash specifik, për përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara të lidhur me inputet nga raportet e NJSBCZHK.</i></p> <p>Gjatë takimeve në Institucion, na u sollën praktika se si ishte proceduar kur pyetësorët kishin evidentuar problematika të lidhura me personelin akademik.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i>  <a href="https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore">https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në UMSH, GVJ konstaton që Institucioni e ka fokusuar kryesisht monitorimin e cilësisë nëpërmjet evidentimit të problematikave nga NJSBCZHK dhe Njësia Bazë. Bazuar në raportet e përgatitura nga NJSBCZHK, Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike adreson problematikën e evidentuar në bashkëpunim me pedagogët përkatës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua nga drejtuesit e njesisë kryesore dhe njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, angazhimi për të përmirësuar programin e studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, duke u bazuar në problematikat e ndeshura si dhe ndryshimeve të kërkesave të tregut.</p> <p><i>Evidenca 18. Rregullore NJSBCZHK.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërjegjësimin e tyre për</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me aktivitete informuese me studentë, trajnime, publikime në faqen Web të UMSH, portalin e studenteve, klasat e krijuara në G-Suite</p>



sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	dhe Zoom Meeting, si dhe publikime në rrjetet sociale, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.  <a href="http://www.usmh.edu.al">www.usmh.edu.al</a>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</li> <li>- Nuk konstatohet prania e analizave formale të punës së njësisë bazë dhe kryesore apo ndonjë plan masash specifik, për përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara.</li> </ul> <p>Drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore në sajë të problematikave të ndeshura dhe ndryshimet në tregun e punës angazhohen në funksion të përmirësimit në vijimësi të cilësisë së programit të studimit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## **Përmbledhje e vlerësimit**

Në përmbledhje të këtij vlerësimi, bazuar në raportin analitik të realizuar në përfundim të procesit, si dhe në dokumentacionin bashkëlidhur RVB, GVJ me gjetjet dhe konstatimet e mësipërme arrin në konkluzionin se Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë Bankë” me profile “Bankat dhe Tregjet Financiare” dhe “Teknologjitë e Reja Financiare”, i ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përmbush standardet dhe kriteret respektive të cilësisë sipas fushave.

## **Pikat e forta dhe afirmime**

1. Institucioni vepron në kuadër të një strukture organizimi të mirë-përcaktuar dhe funksioneve të ndara dhe të qarta mes njërive akademike, në përputhje me Statutin, manualin, dhe rregulloret e tij.
2. Institucioni është aktiv në tregun e punës duke realizuar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit në funksion të procesit mësimor-kërkimor dhe zhvillimit të praktikave mësimor dhe punësimit.
3. Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv informacioni nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.
4. Infrastruktura bashkëkohore fizike dhe logjistike e vënë në dispozicion të programit të studimit ndihmon studentët në përvetësimin e njohurive teorike dhe iu mundëson atyre të marrin shprehje praktike profesionale për fushën.
5. Programi i studimit udhëhiqet dhe realizohet nga kapacitete akademike të specializuara dhe të kualifikuara në fushat e tyre, duke i dhënë prioritet mësimdhënies e mësimnxënies me në qendër studentin, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, si dhe zbatohet në kushte të përshtatshme infrastrukturore.
6. Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me kërkesat e kohës në fushën studimit dhe i mbështetur në një analizë të mirë-hartuar të tregut. Program ka natyrë specifike në përputhje me nevojat e tregut dhe në linjë me zhvillimet e reja të kohës.
7. Studentët kontribuojnë në proceset e vendimarrjes dhe veprimtaritë institucionale të lidhura me procesin mësimor duke u bërë pjesë e strukturave të ndryshme në nivel institucioni dhe njësie kryesore.

## **Pika të dobëta**

1. Përmbajtja e programit të studimit paraqet mangësi në drejtim të njohurive të ofruara (Standardi II.1, Kriteri 1).
2. Programi i studimit mbështetet në metodologji tradicionale të mësimdhënies, dhe ka mangësi në përfshirjen e metodologjive novatore të mësimdhënies, në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e arsimit universitar.(Standardi VI.1, Kriteri 1)

3. Qëndrueshmëria financiare e programit të studimit sfidohet nga ulja e numrit të studentëve, konkurrenca me universitetet publike në profilet ekonomike, dhe ndryshimet demografike në vend. (Standardi IV.5, Kriteri 5)
4. Instrumentet për ruajtjen dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit kanë hapësirë për përmirësime në drejtim të përfshirjes së studentëve, rrjeteve alumni, dhe instrumenteve gjithëpërfshirëse të vlerësimit. (Standardi V.6, Kriteri 4; Standardi VI.3, Kriteri 4; Standardi VI.5, Kriteri 3)

#### *Rekomandime*

1. GVJ rekomandon rishikimin e përmbajtjes së programit të studimit mbi bazën e rekomandimeve në RVJ dhe përpilimin e strategjive të përqendruara në futjen e elementëve novatorë të mësimdhënies, sidomos duke veçuar orientimin e profilit të dytë të programit Master i Shkencave në "Financë Bankë" me profile "Banka dhe Tregje Financiare" dhe "Teknologjitë e Reja Financiare".
2. GVJ rekomandon kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare si për Institucionin, por edhe për Departamentin e Financë Bankë Kontabilitet, dhe specifikisht për këtë program studimit.
3. Në vijim të rritjes së cilësisë të programit të studimit, GVJ konstaton se ka hapësirë për përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse duke mundësuar rritjen e numrit të titujve fizikë dhe online në të cilin kanë akses studentët, me qëllim rritjen e cilësisë së programit, si dhe përfshirjen e zbatimit të teknikave koherente dhe inovative në procesin mësimor-kërkimor.
4. GVJ rekomandon një analizë të thelluar të ecurisë së programit, shoqëruar me rekomandime dhe masa në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. GVJ rekomandon formalizmin e përfshirjes së rrjetit ALUMNI në politikën dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. GVJ sugjeron se realizimi i anketimit të studenteve duhet të realizohet me një pjesëmarrje më të madhe të të gjithë studenteve të MSH në FB. Kjo do të rriste më shumë nivelin dhe rëndësinë e kësaj forme vlerësimi.

## Summary of the Evaluation

Based on the analytical report completed at the conclusion of the process and the accompanying documentation, the Evaluation Group has reached the conclusion that the Second Cycle Master's Degree Program in "Finance-Banking" with specializations in "Banks and Financial Markets" and "New Financial Technologies," offered by the "Mediterranean University of Albania," meets the respective quality standards and criteria across various areas.

## Strengths and Affirmations

1. The institution operates within a well-defined organizational structure with clear and distinct functions among the academic units, in line with its Statute, manuals, and regulations.
2. The institution is active in the job market, having established a significant number of collaboration agreements with institutions and organizations both domestically and internationally, supporting the teaching-research process and the development of internships and employment opportunities.
3. The institution has an effective information management system through which it administers information related to students and their activities, from enrollment to graduation.
4. The modern physical and logistical infrastructure available for the study program aids students in acquiring theoretical knowledge and allows them to gain practical professional skills in the field.
5. The study program is led and delivered by specialized and qualified academic capacities in their fields, prioritizing student-centered teaching and learning in accordance with the institution's strategic objectives, and is implemented in suitable infrastructural conditions.
6. The study program is designed to meet current demands in the field of study and is based on a well-prepared market analysis. The program has a specific nature aligned with market needs and current developments.
7. Students contribute to decision-making processes and institutional activities related to the educational process by participating in various structures at the institutional and main unit levels.

## Weaknesses

1. The content of the study program (courses, syllabi) presents shortcomings in the knowledge offered. (Standard II.1, Criterion 1).
2. The study program relies on traditional teaching methodologies and lacks the inclusion of innovative teaching methodologies, in line with international developments in higher education (Standard VI.1, Criterion 1).

3. The financial sustainability of the study program is challenged by a decrease in student numbers, competition with public universities in economic profiles, and demographic changes in the country (Standard IV.5, Criterion 5).
4. There is room for improvement in the instruments for maintaining and ensuring the quality of the study program in terms of student involvement, alumni networks, and comprehensive evaluation tools (Standard V.6, Criterion 4; Standard VI.3, Criterion 4; Standard VI.5, Criterion 3).

### Recommendations

1. The Evaluation Group recommends revising the content of the study program based on the recommendations in the Report and developing strategies focused on the introduction of innovative teaching elements, especially emphasizing the orientation of the second profile of the Master's program in "Finance-Banking" with specializations in "Banks and Financial Markets" and "New Financial Technologies."
2. The Evaluation Group recommends conducting a financial sustainability analysis for both the Institution and the Department of Finance-Banking Accounting, specifically for this study program.
3. To further improve the quality of the study program, The Evaluation Group notes that there is room for updating the core and supplementary literature by increasing the number of physical and online titles accessible to students, with the aim of enhancing program quality and incorporating coherent and innovative techniques into the teaching-research process.
4. The Evaluation Group recommends a thorough analysis of the program's progress, accompanied by recommendations and measures aimed at the continuous improvement of quality. The Evaluation Group recommends formalizing the involvement of the ALUMNI network in the policies and procedures for ensuring the quality of the study program. The Evaluation Group suggests that student surveys should be conducted with greater participation from all students in the Master of Science in Finance-Banking program. This would enhance the level and importance of this form of evaluation.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

